



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
 Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve



Nr. 310 Prot

Tirane ___/___/2011

Relacion

Per llogaritjen e tarifave te prodhimit te energjise elektrike, te sherbimit te furnizimit me shumice, transmetimit, shperndarjes, furnizimit me pakice te energjise elektrike per konsumatorët tarifore per periudhen e trete rregullatore (2012-2014).

Bordit te Komisionereve

KESH sh.a, OST sh.a dhe CEZ Shperndarje sh.a, kane paraqitur prane ERE-s kerkesat per rishikimin e tarifave dhe cmimeve te sherbimeve te prodhimit/shitjes me shumice, te transmetimit, te shperndarjes dhe te shitjes me pakice te energjise elektrike per periudhen rregullatore 2012-2014, perkatesisht me shkresat Nr. Prot.4833, date 31.08.2011, Nr.4458prot date 01.09.2011 si dhe Nr. 2068,Prot., date 02.09.2011.

Tarifat e te gjitha veprimtarive te energjise elektrike reflektohen tek çmimet e shitjes me pakice per klientet fundore, dhe per sa percaktuar ne Ligjin nr.9072 date 22.05.2003 "Per sektorin e energjise elektrike", i ndryshuar, neni 8 pika 2, dhe neni 26, kerkesat e paraqitura per rishikimin e ketyre tarifave jane shqyrtuar njekohesisht pergjate gjithe procesit, qe nga aplikimi i tyre, publikimi nga shoqerite perkatese dhe ERE dhe deri ne miratimin e tyre perfundimtar.

Per sa me siper nga grupi i punes i ngritur me Urdhrin e Kryetarit te ERE-s nr. 109 date, 05.09.2011 "Per shqyrtimin e aplikimeve te tarifave te prodhimit, shperndarjes dhe furnizimit te energjise elektrike", kerkoi edhe paraqitjen e aplikimit per rishikimin e cmimit te TEC-Vlore, si dhe ne te njejten kobe jane shqyrtuar edhe kerkesat per percaktimin e tarifave te prodhimit te energjise elektrike nga tre shoqerite e sapokrijuara:

- HEC Lanabregas
- HEC Bistrice
- HEC Ulez Shkopet

Ne mungese te nje statusi te mirepercaktuar per keto tre kompani ne shqyrtimin e aplikimeve te ketyre shoqerive Grupi i Punes ka gjykuar se ato do te funksionojne si shoqeri publike dhe energjia e pritshme per tu prodhuar prej HEC-eve ne zoterim te tyre do te sherbeje per plotesimin e nevojës per energji elektrike te Furnizuesit Publik me Shumice . Ligji nr.9072 date 22.05.2003 "Per sektorin e energjise elektrike", i ndryshuar ne nenin 26, pika 1 percakton se:

“ERE-ja është institucioni përgjegjës për vendosjen e tarifave të energjisë elektrike për të gjitha veprimtaritë e rregulluara, që kryhen nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”

Po ashtu ne Modelin e Tregut te Energjise Elektrike, miratuar me VKM nr.338 date 18.03.2008, ne pikën 4.13 percaktohet se marredheniet e Furnizuesit Publik me Shumice me PVE apo PPE i perkasin tregut te rregulluar, karakteristike e te cilit eshte funksionimi i marredhenieve mes paleve me tarifa dhe terma kontrate te miratuar nga ERE.

Sikurse cituar edhe me lart ne mbeshtetje te neneve 26 dhe 27 te Ligjit nr.9072, date 22.05.2003 "Per sektorin e energjise elektrike", te ndryshuar, dhe te akteve te tjera nenligjore, aplikimet e shoqerive jane shqyrtuar **njekohesisht** nepermjet nje procesi publik dhe tejet transparent, duke ndjekur dhe respektuar te gjitha procedurat ligjore per shqyrtimin, llogaritjen dhe miratimin perfundimtar te ketyre tarifave, ne perputhje me kuadrin ligjor si dhe me Rregullat dhe Metodologjite e miratuara prej ERE-se.

Ne kete relacion jepen te detajuara analizat perkatese te bera nga ana e Grupit te Punes te ngritur per kete qellim, lidhur me te gjita kerkesat per te ardhura te cdo aktiviteti qe parashikohet te kryhen nga te gjitha shoqerite e licensuara, perfshire proceduren dhe hapat e ndjekura ne gjithe kete proces.

Permbajtja

1. BAZA LIGJORE DHE PROCEDURA E NDJEKUR PER SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE:	4
2. LLOGARITJA E TARIFAVE DHE CMIMEVE PER VITIN 2012-2014.	6
2.1 BILANCI ELEKTROENERGJITIK.	6
2.2 TARIFA E PRODHIMIT TE ENERGIJE ELEKTRIKE PER KESH SH.A.	10
Korrigjimi i te ardhurave te kerkuara per vitin 2011	10
Percaktimi i kerkeses per te ardhura per peridhen e trete rregullatore 2012-2014	12
Shpenzimet Operative (OPEX)	14
Shpenzimet Kapitale (CAPEX)	15
2.3 TARIFA E PRODHIMIT TE ENERGIJE ELEKTRIKE PER TEC VLORE SH.A.	17
2.4 Cmimi i shitjes se energjise elektrike nga HEC Ulez & Shkopet sh.a., HEC Bistrica 1 Bistrica 2 sh.a.dhe HEC Lanabregas sh.a. per periudhen 2012-2014.	26
2.5 TARIFA E SHERBIMIT TE SHITJES ME SHUMICE TE ENERGIJE ELEKTRIKE NGA FPSH	31
2.6 Ne lidhje me percaktimin e tarifes per sherbimin e Furnizimit te Alternatives se Fundit	Error! Bookmark not defined.
2.7 TARIFA E SHERBIMIT TE TRANSMETIMIT PER OST SH.A.	38
Elementet e OPEX-it	43
Elementet e CAPEX - it	44
Amortizimi	44
Kthimi mbi bazen e rregulluar te asetëve	45
2.8 TARIFA E SHERBIMIT TE SHPERNDARJES SE ENERGIJE ELEKTRIKE PER OSSH SH.A. PER PER PERIUDHEN E TRETE RREGULLATORE 2012-2014.	46
Vleresimi i kerkeses per te ardhura te kompanise CEZ-Shperndarje per cdo vit te periudhes se trete rregullatore 2012-2014.	Error! Bookmark not defined.
2.9 TARIFA E SHERBIMIT TE FURNIZIMIT ME PAKICE (FPP) TE ENERGIJE ELEKTRIKE PER PERIUDHEN 2012-2014	60
2.10 Tarifa e aksesit	67
2.11 Ne lidhje me tarifen e energjise se furnizuar ne periudhen e pik-ut.	68
2.12 Ne lidhje me aplikimin e tarifes fikse per konsumatorët jo familare ne TM.	70
2.13 Tarifa e konsumatoreve familjare me dy blloqe konsumi	70
2.14 PERCAKTIMI I ÇMIMIT TE SHITJES TE ENERGIJE PER HEC-et EGZISTUES ME FUQI TE INSTALUAR DERI NE 10 MW DHE TE RINJ ME FUQI DERI NE 15 MW.	72
Cmimi i shitjes se energjise elektrike per HEC-et ekzistues me fuqi te instaluar deri ne 10 MW	72
2.15 Cmimi i shitjes se energjise elektrike per HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri 15 MW	73

1. BAZA LIGJORE DHE PROCEDURA E NDJEKUR PER SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE:

- 1- Enti Rregullator i Energjise, ne zbatim te neneve 9 dhe 26 te Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 "Per sektorin e energjise elektrike", te ndryshuar, dhe neneve 18, 20 dhe 21 te Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE, miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve nr.21, date 18.03.2009, te ndryshuar, pasi mori ne shqyrtim aplikimet e paraqitura nga KESH sh.a., TEC Vlore sh.a, OST CEZ Shperndarje, sh.a, *me Vendimet e Bordit te Komisionereve nr. 82, 83,84, 85, dhe nr. 86 date 13.09.2011,* vendosi fillimin e procedurave per percaktimin e tarifave respektive te aktiviteteve te energjise elektrike, vendime te cilat jane publikuar ne *Fletoren Zyrtare* Nr.141, date 17.10.2011.
- 2- Aplikimet e KESH sh.a, TEC Vlora sh.a, Hec Lanabregas sha, HEC Bistrice sh.a, HEC Ulez Shkopet sh.a, OST sh.a dhe CEZ Shperndarje sh.a, jane publikuar ne gazete. ERE ka qene e hapur dhe ka vene ne dispozicion dokumentacionin e aplikimeve per te gjitha palet e interesuara, si dhe ka bere publikimin e ketyre aplikimeve edhe ne faqen zyrtare te internetit te ERE www.ere.gov.al.
- 3- Bazuar ne vendimet e siperpermendura per fillimin e procedurave te shqyrtimit te kerkesave per rishikimin e tarifave dhe cmimeve te shitjes se energjise elektrike per vitet 2012-2014, ERE ka pasur nje korrespondence te gjere dhe intensive me keto shoqeri, nepermjet te ciles eshte kerkuar paraqitja e shpjegimeve, informacioneve dhe dokumentave plotesuese lidhur me aplikimet e tyre.
- 4- Ne mbeshtetje te Rregullave te Praktikave dhe Procedurave te ERE-s, konkretisht te neneve 29 dhe 31 pika 1 dhe 2, te miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s, Nr.21, date 18.03.2009, te ndryshuar, nga data 14-24 Nentor 2011 si dhe me pas ne vijimesi deri me 30 Nentor 2010, midis perfaqesuesve te ERE-s dhe perfaqesuesve te KESH sh.a./FPSH, TEC Vlore sh.a, OST sh.a. dhe CEZ shperndarje., jane zhvilluar seanca degjimore teknike lidhur me shqyrtimin e aplikimeve perkatese te shoqerive per tarifat e enegjise elektrike per vitin 2012-2014.
- 5- Ne daten 30.11.2011, ERE, organizoi seancen zyrtare publike, ne te cilen u ftuan te merrnin pjese per te diskutuar dhe shprehur qendrimet dhe opinionet e tyre lidhur me keto aplikime te gjitha institucionet, shoqatat e mbrojtjes se konsumatoreve, si dhe te gjitha palet e tjera te interesuara dhe perfaqesues te publikut te gjere, nepermjet njoftimit i cili u publikua nga ERE ne median e shkruar dhe ate vizive. Mendimet e paleve te shprehura ne kete seance u shqyrtuan nga Grupi i Punes i ERE-s i ngritur per kete qellim, i cili nga analiza e kerkesave te shprehura nga palet e treta

ne seance veren se pyetjet dhe komentet e paleve ishin te nje karakteri te pergjithshem duke kerkuar te mos lejohet nje rritje abuzive dhe e paargumentuar e cmimeve te energjise elektrike, qe do te rendonte padrejtesisht konsumatorët e rregullt familjare. Persa me siper, grupi i punes duke vleresuar se kerkesat e paleve nuk bazohen ne llogaritje te shifrave, procedoi me studimin e aplikimeve ne perputhje me kerkesat e akteve ligjore dhe nenligjore, qe lidhen me percaktimin e tarifave dhe cmimeve sic pershkruhen me tej ne kete relacion.

Pas realizimit te ketij procesi transparent, Grupi i Punes i ngritur nga ERE per shqyrtimin dhe percaktimin e tarifave te propozuara ne vijim nga Grupi i Punes, u mbeshtet dhe mori ne konsiderate parimet baze te vendosjes se tarifave te percaktuara ne:

1. Vendimin nr. 77, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, "Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per kompanine publike te gjenerimit te energjise elektrike";
2. Vendimin nr. 78, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, "Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me shumice te energjise elektrike";
3. Vendimin nr. 59, date 29.12.2005, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, "Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes se transmetimit te energjise elektrike";
4. Vendimin nr. 79, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, "Per miratimin e metodologjise se llogaritjes te tarifes se shperndarjes te energjise elektrike";
5. Vendimin nr. 80, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, "Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me pakice te energjise elektrike".
6. Deklaraten Rregullatore, miratuar nga Bordi i Komisionereve me Vendimin Nr. 12, date 03.03.2009,
7. Vendimin nr. 46 dt.14. 06.2010 "Mbi kerkesen e OSSH sh.a lidhur me nivelin e humbjeve te energjise per vitin 2008".
8. Vendimin nr.93, date 30.11.2010 " Per miratimin e programit te uljes se humbjeve totale per tre periudhat e rregullimit".
9. Vendimin nr. 99 datë 30.09.2011 te Bordit te Komisionereve "Mbi miratimin e Studimit per Borxhin e Keq"

Duhet vene ne dukje se ne percaktimin e tarifave dhe cmimeve per vitet 2012-2014, Grupi i Pune u bazua edhe ne ndryshimet me te fundit te Ligjit nr.9072 date 22.05.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike". Pikerisht, ne baze te ndryshimeve te miratuara nga Kuvendi me Ligjin nr.10485, date 26.11. 2011, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar". liberalizohet me tej tregu i shitjes me pakice, e cila ndryshon edhe strukturen e klienteve tarifore pasi nepermejt ketyre ndryshimeve te gjithë klientet e lidhur ne tension te larte dhe ato me nje konsum mbi 50 GWh ne vit konsiderohen automatikisht Konsumatore te Kualifikuar furnizimi i te cileve kryhet me cmime te negociuara lirisht prej tyre me Furnizuesit e Kualifikuar ne tregun e parregulluar duke ndikuar direkt ne reduktimin e te ardhurave te kerkuara per mbulimin e kostove te importit te energjise elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumice.

Duke patur parasysh parimet e percaktuara ne aktet nenligjore te mesiperme dhe sikurse theksuar edhe me lart duke qene se tarifat e sherbimeve te energjise elektrike jane te transferueshme tek cmimet e shitjes me pakice per klientet fundore tarifore, kerkesat e paraqitura per rishikimin e ketyre tarifave nga te kater shoqerite, u shqyrtuan njekohesisht pergjate gjithë procesit te ndjekur nga ERE.

2. LLOGARITJA E TARIFAVE DHE CMIMEVE PER VITIN 2012-2014.

2.1 BILANCI ELEKTROENERGJITIK

Ne kerkesat e paraqitura ne ERE u konstatua se te kater shoqerite jane mbeshtetur ne te njejtat parashikime te kerkeses per energji elektrike per vitin 2012-2014. Parashikimi i kerkeses per energji elektrike per vitin pasardhes pergatitet nga Cez Shperndarje ne funksionin e saj si Furnizues Publik me Pakice, parashikim i cili sherben si baze per parashikimet e kerkeses per Sistemin e Transmetimit dhe te kerkeses qe duhet te permbushë FPSH ndaj FPP.

Nisur edhe nga eksperienca negative e vitit te kaluar procesi i shqyrtimit te kerkeses nga ana jone, bazuar ne te dhenat e aplikimit te CEZ Shperndarje, eshte trajtuar me shume kujdes.

Per vitin 2011 kerkesa nga ana e CEZ Shperndarje paraqitet me rritje te konsiderueshme prej 905 GWh ose 21.4% me shume krahasuar me ate te kerkuar dhe te miratur nga ERE ne percaktimin e tarifes se shitjes se energjise me pakice per klientet tarifore per vitin 2011. Ne lidhje me kete rritje te kerkeses verejme se :

1. Nisur nga raportimet periodike te shoqerise ÇEZ Shperndarje si dhe nga monitorimi i kryer nga ana e ERE-s eshte konstatuar se ne kerkesen per energji eshte perfshire edhe energjia e faturuar si dem ekonomik per konsumatoret qe marrin energji elektrike ne menyre te parregullt. (Sqarojme

se energjia e faturuar deri me 30.09.2011 si dem ekonomik ka qene rreth 200 GWh). Energjia e faturura si dem ekonomik e paraqitur ne aplikim e CEZ Shperndarje per vitin 2011 parashikohet 250GWh.

ERE e ka konsideruar te parregullt menyren e faturimit dhe konsiderimin e kesaj sasi energjie elektrike te faturuar si dem ekonomik si rritje kerkese dhe si detyrim te Furnizuesit Publik me Shumice per te siguruar dhe furnizuar kete sasi energjie Nga ana e Shoqerise nuk eshte pranuar reduktimi i kerkeses per kete energji te konsideruar si “ dem ekonomik’ , megjithate grupi i punes e ka gjykuar te arsyeshme zbritjen e ketij zeri prej 250GWh.

2. Gjate analizes se parashikimit te kerkeses per energji konstatohet edhe nje rritje e pajustificuar plotesisht e kerkeses per vitin 2012 nga ai i priteshem me arsyetimin sa me poshte vijon :

Kerkesa e paraqitur nga

CEZ	2011	2012	2013	2014
Konsumatore ne TL	602,964	625,453	625,453	625,453
Konsumatore ne 110 kV	69,538	193,015	193,015	193,015
Konsumatore ne 35 kV	47,371	47,536	49,200	50,922
Konsumatore ne 20/10/6 kV	781,958	889,481	920,613	952,835
Konsumatore ne 0.4 kV	932,484	899,899	931,395	963,994
Konsumatore Familjare	2,699,609	2,757,746	2,854,267	2,954,167
Konsum Vetjak	6,593	5,594	5,790	5,992
Totali	5,140,517	5,418,724	5,579,733	5,746,378

Nese analizojmë rritjen e kerkeses faktike per te gjithë klientet sipas niveleve te tensionit per periudhen 2008-2011 paraqitet si me poshte :

	2008	2009	2010	I priteshem	Parashikim
	2008	2009	2010	2011	2012
Kliente ne OST	185,445	187,518	270,306	602,964	625,453
Kliente ne 110 kV		34,998	34,174	69,538	193,015
Kliente ne 35 kV	58,692	55,960	50,022	47,371	47,536
Kliente ne 20/10/6 kV	718,047	732,617	715,893	777,508	889,481
Kliente ne 0,4 kV	776,656	837,377	816,699	820,177	778,276
Familjare	2,287,152	2,415,562	2,275,200	2,404,621	2,481,670
Te tjera	83,008	21,045	65,407	58,237	58,292
Totali	4,109,000	4,285,077	4,227,701	4,780,415	5,073,724
% rritjes totali		4.29%	-1.34%	13.07%	6.14%

Burimi : Te dhenat e raportimeve periodike te derguara nga OSSH sh.a per vitin 2008 si dhe te dhenat ne Sheet-in version 5 te Tariff Application Energy Balance te cilat ndryshojne dukshem nga te dhenat e paraqitura nga aplikimi.

Bazuar ne tabelen e mesiperme kerkesa e Shoqerise prej 5140 GWh per vitin 2011 duket joplotesisht e bazuar. Parashikimi i pritshem per vitin 2011 nisur nga te dhenat historike per vitet 2008, 2009, 2010 te paraqitura ne tabelen e mesiperme nuk mund te shkoje me teper se 9% rritje me nje tolerance maksimale nga viti 2010 ne 2011, duke konsideruar se rritja me e madhe e kerkeses ka ardhur nga rritja kerkeses per energji elektrike per konsumatoretqe furnizohen ne TL.

Per sa me siper u gjykua se kerkesa per vitin 2011 te jete ne nivelin e 4607 GWh dhe ky nivel do te sherbeje per axhustimin e llogaritjeve te bera per tarifen e FPSH, per tarifen e transmetimit, shperndarjes dhe te FPP-se.

Ne vijim te ketij arsytimi ,grupi i punes propozon te reduktohet kerkesa e paraqitur nga FPP per vitet 2012-2014 duke ruajtur nje rritje prej 4% ne vit.

Ne vijim, paraqitet bilanci elektroenergjetik i pranuar per llogaritjen e tarifave te sherbimeve te energjise elektrike per vitin 2011. Bilanci elektroenergjetik eshte ndertuar mbi bazen e roleve, pergjegjesive, dhe marredhenieve financiare te ndertuara ndermjet te gjitha shoqerive sipas parashikimeve te Modelit Shqiptar te Tregut.

Tabela nr.2 " Bilanci Elektroenergjtik"

GWh	I prishtshmi							
	2008	2009	2010	2011	2011	2012	2013	2014
Kerkesa	4,109	4,151	4,378	4,553	4,806	4,111	5,579	5,746
Prodhimi bruto	3,720	5,192	4,267	4,250	4,341	4,200	4,200	4,200
konsumi vetjak	5	10	13	13	5	6	6	6
humbje ne prodhim	11	36	43	34	20	19	19	19
Prodhim neto	3,704	5,146	4,211	4,203	4,316	3,837	3,837	3,837
Prodhim nga HEC-et lokale	69	68	64	68	-116			
Shuma e Prodhimit Publik	3,773	5,214	4,275	4,271	4,200	3,837	3,837	3,837
Shitur OST per humbje	214	258	296	225	220	226	228	227
Shitur OSSH per humbje	-	286	-	-	-	-	-	-
Shitur sherbime ndihmese	-	6						
Shitje/Export	59	463	-	-	232	-	-	-
Prodhimi disponibel per shitje tek FPSH	3,500	4,201	3,979	4,046	3,748	3,611	3,609	3,610
FPSH								
Prodhimi Publik	3,500	4,201	3,979	4,046	3,748	3,611	3,609	3,610
Prodhimi nga TEC Vlore		0	245	24	51	72	0	0
Prodhim nga HEC-et private	62	91	85	165	127	228	270	280
Importi nga FPSH	547	29	22		681		33	193
prodhim nga 3 Hec-et e ndare						200	363	363
import per dif te tec-it			47					
Blere nga FPSH	4,109	4,321	4,378	4,235	4,607	4,111	4,275	4,446
Shitur per FPP	4,109	4,151	4,378	4,235	4,607	4,111	4,275	4,446
	-	(170)	-	-	0	(0)	0	0
Energjia e levruar ne OST								
Levruar nga FPSH	4,109	4,151	4,378	4,235	4,607	4,111	4,275	4,446
Energji per humbjet e OST	214	258	296	225	220	226	228	227
Energji per humbjet e OSSH nga prodhim	-	286	-	-	-	-	-	-
Import nga OSSH per humbje	1,927	1,947	1,705	1,547	1,551	1,293	1,064	906
Eksport	59	463	-	-	232	-	-	-
levruar nga TSO per KK				300				
Nga KK-Tso	11	31	100		603	819	819	819
Shuma	6,320	7,136	6,479	6,307	7,214	6,448	6,386	6,398
OSSH/FPP								
Shitje per klientet tarifore	4,109	4,151	4,378	4,235	4,607	4,111	4,275	4,446
Per Humbjet	1,927	1,947	1,705	1,547	1,551	1,293	1,064	906
Per KK	11	31	100	-				
Shuma	6,047	6,129	6,183	5,782	6,159	5,403	5,339	5,352
minus konsumi ne TL	(197)	(182)	(250)	(240)	(603)			
Energjia e Levruar ne Shperdarje	5,850	5,947	5,933	5,542	5,556	5,403	5,339	5,352

2.2 TARIFA E PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE PER KESH SH.A.

Llogaritja e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike është bazuar në metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE dhe është mbështetur në analizën e kërkesave për të ardhura të paraqitur në aplikimin e KESH sh. a. të datës 1.09.2011, e cila ka konsistuar në analizën :

- E të dhënave në lidhje me vlerësimin dhe axhustimin e tarifës për vitin aktual 2011.
- Kërkeses për të ardhurat e kerkuara për aktivitetin e prodhimit publik për periudhën 2012-2014.

Korrigjimi i të ardhurave të kerkuara për vitin 2011

Pas kërkesës së bere nga KESH sha, në lidhje me parashikimin e pritshëm të prodhimit të energjisë elektrike si dhe nisur nga rezultatet faktike Grupi i punës ka bere korrigjimet përkatëse në llogaritjen e tarifës për vitin aktual 2011 si me poshte:

1. Mbeshtetur në pikën 2.5 të Deklaratës Rregullatore niveli i vjetor i prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike për efekt të llogaritjes së prodhimit të energjisë elektrike do të llogaritet në nivelin 4,200 GWh, pra 71 GWh më pak nga ai paraqitur në aplikim nga ana e kompanisë.
2. Korrigjimi i të ardhurave nga eksporti i parashikuar i energjisë elektrike për vitin 2011 për shumën 619 milion leke.

Llogaritur nga ERE	1900 milion leke
Realizuar për periudhën Janar-Gusht (232.128 MWh=9,280,982 Eur)	1304 milion leke
diferenca	596 milion leke

Si rezultat i korrigjimeve të mesipërme tarifa e prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2011 rezulton tarifa e pritshme e gjenerimit 0.78 leke /kWh nga ajo e miratuar 0.63leke/kWh, pra me një rritje prej 23.8 %

Të ardhurat e munguara të shoqërisë KESH sh.a për vitin 2011, në shumën prej 596 milion leke do të kompensohen në periudhën pasardhëse rregullatore.

Tabela nr.3 në vijim paraqet kostot dhe rivlerësimet e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike për KESH sh.a për vitin 2011.

Zeri	2011	2011.1
Mirembajtje	276	276
Personeli	1,170	1170
Furnitura e Sherbime	987	987
Totali OPEX	2,433	2,433
Vlera e asetëve	37,567	37,567
Amortizimi I akumuluar	7,233	7,233
Vlera neto e Asetëve	30,334	30,334
Kapitali I Punes	203	203
Investime	1,945	1,945
Amortizimi I Vitit	879	879
Baza e Rregulluar e Asetëve(RAB)	31,603	31,603
Kthimi I Lejuar mbi Kapitalin pas Taksave	4.5%	4.5%
Raporti I Synuar I Kapitalit te Vet	40.0%	40.0%
Kosto Mesatare e borxhit	3.7%	3.7%
Raporti I Synuar I Borxhit	60.0%	60.0%
WACC	4.0%	4.0%
Fitimi	1,270	1,270
arketuar nga OST humbje te ardhura nga interesat		
Te ardhurat e Kerkuara	4,583	4,582
Eksport I energjise Elektrike axhustim I te ardhurave per vitin 2011	(1,900)	(1,304)
Te ardhurat e kerkuara minus Eksportin	2,683	3,279
Te ardhurat e Kerkuara Neto	2,683	3,279
Energjia e Prodhuar	4,271	4200
Tarifa Mesatare e Prodhimit	0.63	0.78

Percaktimi i kerkeses per te ardhura per peridhen e trete rregullatore 2012-2014

Ne aplikimin e tij KESH sh.a ka paraqitur nje sasi prodhimi te parashikuar per vitet 2012-2014 respektivisht prej 3831 GWh, 4385 GWh dhe 4387 GWh bazuar ne kapacitet e instaluara sipas njesive gjeneruese si me poshte:

Njësia Gjeneruese	Numri i Agregatëve	Fuqia e instaluar (MW)	Viti i Komisionimit
HEC Fierza	4	500	1978
HEC Koman	4	600	1985
HEC Vau i Dejës	5	250	1971
HEC Ulëz	4	25.2	1958
HEC Shkopet	2	24	1963
HEC Bistrica 1	3	22.5	1965
HEC Bistrica 2	1	5	1966
HEC Lanabregas	2	5	1951
Total	25	1431.7	

Ne zbatim te Ligjit Nr. 10430, date 09.06.2011 "Per Krijimin e shoqerise " Hec Ulez Shkozet" sh.a.; "Hec Lanabregas" sh.a.; " Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. dhe ne reference te Urdhrit te Ministrit te Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes me Nr. 594, date 29.08.2011 "Per Zvogelimin e Kapitalit te Korporates Elektroenergjitike Shqiptare", i eshte kerkuar KESH sha. te beje rillogaritjet e te ardhurave te kerkuara dhe prodhimit te energjise elektrike duke konsideruar tashme qe keto hidrocentrale jane jashte prodhimit te energjise elektrike nga burimet hidro te KESH sh.a.

Keshtu qe nga ana e Grupit te Punes per periudhen e trete rregullatore per KESH sh.a duke pranuar qe prodhimi i pritshem i ketyre HEC-eve perllogaritet ne rreth 360 GWh, eshte konsideruar nje nivel prodhimi prej 3,837 GWh.

Ne vijim po paraqesim kerkesen per te ardhura nga Shoqeria Publike e Gjenerimit per periudhen e trete rregullatore si dhe axhustimet e bera pergjate analizes.

Tabela nr.4: Struktura e kostove dhe tarifa perkatese per KESH GEN (000 leke)

Zeri	Propozuar ERE			Aplikuar nga KESH		
	2012	2013	2014	2012	2013	2014
Mirembajtje	212	205	215	268	265	278
Personeli	995	1,046	1,100	1442	1513	1594
Furnitura e Sherbime	680	716	755	752	774	798
Totali OPEX	1,887	1,967	2,070	2,462	2,552	2,670
Vlera e aseteve	34,257	36,528	40,143	38693	41379	43583
Amortizimi I akumuluar	6,543	7,223	7,939	7731	8570	9453
Vlera neto e Aseteve	27,714	29,305	32,204	30,962	32,809	34,130
Kapitali I Punes	157	164	173	205	213	223
Investime	2,271	3,615	2,446	4542	2687	2204
Amortizimi I Vitit	680	716	755	838	883	930
Baza e Rregulluar e Aseteve(RAB)	29,463	32,368	34,067	34,871	34,826	35,627
Kthimi I Lejuar mbi Kapitalin pas Taksave	7.34%	7.34%	7.34%	7.34%	7.34%	7.34%
Raporti I Synuar I Kapitalit te Vet	40%	40%	40%	40.00%	40.00%	40.00%
Kosto Mesatare e borxhit	5.26%	4.80%	4.50%	5.26%	4.80%	4.50%
Raporti I Synuar I Borxhit	60%	60%	60%	60.00%	60.00%	60.00%
WACC	6.09%	5.82%	5.64%	6.09%	5.82%	5.64%
Fitimi	1,795	1,883	1,920	2,124	2,025	2,008
arketuar nga OST humbje				-226	-232	-240
te ardhura nga interesat	-1001	-900	-801	-1001	-901	-802
Te ardhurat e Kerkuara	3,361	3,666	3,944	4,197	4,327	4,566
Eksport I energjise Elektrike				0	0	0
axhustim I te ardhurave per vitin 2011	596					
Te ardhurat e kerkuara minus Eksportin	3,957	3,666	3,944	4,197	4,327	4,566
Te ardhurat e Kerkuara Neto	3,957	3,666	3,944	4,197	4,327	4,566
Energjia e Prodhuar	3837	3837	3837	3832	4386	4388
Tarifa Mesatare e Prodhimit	1.03	0.96	1.03	1.10	0.99	1.04

Shpenzimet Operative (OPEX)

Shpenzimet per mirembajtje

Nisur nga te dhenat historike per vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011 keto shpenzime luhaten ne kufijte 250 -280 milion leke ne vit. Per me teper, nga kontrolli i shpenzimeve te vitit ushtrimor 2010 dhe 2011 si dhe gjate seancave teknike te zhvilluara me Shoqerine KESH sh.a, Grupi i Punes gjykon qe shpenzimi i pritshem per vitin 2012 te reduktohet per shumen 53-63 milion leke sipas periudhes respektive 2012-2014 per arsyet si me poshte:

- Shkeputja nga Shoqeria Publike e Prodhimit te tre hidrocentraleve afersisht 60 milion leke per cdo vit te periudhes rregullatore.

Per keto arsye, ne kushte normale te gjendjes financiare shpenzimet sipas tabelës nr. 4 jane konsideruar si te arsyeshme.

Shpenzimet per paga

Shpenzime per pagat ne aplikimin e dates 1.09.2011 nga ana e Shoqerise jane kerkuar per vitin 2012 rreth 23% me te larta se ato te njohura ne tarifen e vitit 2011, ndersa per vitin 2013 dhe 2014 eshte indeksuar me inflacionin e pritshem.

Gjate seancave te perbashketa me perfaqesues te Shoqerise eshte arritur ne rregullimin e meposhtem :

- Zbritja e fondit te pagave per shumen per 313 milion leke si pasoje e shkeputjes se tre HEC-eve ne zbatim te Ligjit nr.10430 date 09.06.2011” per krijimin e shoqerive Hec Ulez Shkopet sh.a, HEC Lanabregas sh.a, HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2”.
- Reduktimi i metejshem ketij zeri per 134 milion leke, meqe mungon argumentimi i kerkeses se paraqitur nga ana e Shoqerise.Grupi i punes propozon qe fondi i pages te reduktohet perseri me vleren prej 134 milion leke per secilin vit te periudhes se trete rregullatore.

Bazuar ne analizen e numrit te punonjesve dhe fondit te pagave te realizuara per vitin 2010 dhe ai i pritshem per vitin 2011, fondi i pagave i njohur per vitin 2011 eshte i konsiderueshem dhe realisht perfaqeson nevojat e kompanise per kete ze te OPEX-t si dhe reduktimi i tij reflekton nje rritje prej 3.7% si pasoje e indeksimit.

Tabela 5: Fondi i pagave per vitet 2010 dhe 2011

	Miratur nga ERE (mln. Leke)	Realizuar (mln. Leke)
Fondi i pagave per vitin 2010	1,145	1,249
Fondi i pagave per vitin 2011	1,118	1,120

“Furnitura dhe sherbime”,

Lidhur me zerin e shpenzimeve “*Furnitura dhe sherbime*”, Shoqeria, ne kerkesen per te ardhura ka kerkuar nje shume prej 752 milion lekesh.

Pas verifikimit te ketij shpenzimi si dhe shpjegimeve te bera nga Shoqeria gjate seancave teknike te organizuara nga ana e ERE-s, Grupi i Punes eshte i mendimit qe ky ze te ulet me 72 milion leke ose me 9,5 % nga sa eshte propozuar nga Shoqeria. Kjo per efekt te reduktimit te shpenzimeve ne kete ze si pasoje e shkeputjes se pese hidrocentraleve te permendura me siper. Vlera e ketij shpenzimi per vitet 2012-2014 perkatesisht 680 milion leke, 716 mil leke dhe 755 milion leke vleresohet qe eshte e aresyeshme, duke perfshire ketu indeksimin per shkak te inflacionit si dhe sherbimeve nga te tretet per mbajtjen ne gatishmeri te paisjeve gjeneruese.

Shpenzimet Kapitale (CAPEX)

Amortizimi

Amortizimi - eshte llogaritur nga KESH/GEN duke perdorur normat fiskale te amortizimit, sic dhe parashikohet ne metodologjine e llogaritjes se tarifes se prodhimit te energjise elektrike. Ky shpenzim eshte llogaritur nga KESH perkatesisht ne vleren 838 milion leke, 883 milion leke, 930 milion leke respektivisht per periudhen 2012-2014.

Bazuar ne Pasqyrat Financiare te raportuara per vitin 2010 ky shpenzim paraqitet per 782 milion leke nga 829 milion leke i miratur per vitin 2010, diference qe se bashku me amortizimin e priteshem te vitit 2011 do te rillogariten ne vleren e amortizimit dhe RAB-it per vitin 2012. Duke marre ne konsiderate shtimin e asetëve te reja per vitin 2011 dhe 2012-2014 afersisht me shumen 11.400 milion

leke, gjykojme qe te ardhurat per mbulimin e kostos se amortizimit te propozuara sipas tabelës se mesiperme jane te arsyeshme.

Kthimi mbi bazen e rregulluar te asetëve

Ne llogaritjen e Bazes se Rregulluar te Asetëve (RAB) per shumen 29.463 milion leke per vitin 2012, 32.368 milion leke per vitin 2013 dhe 34.067 milion leke per vitin 2013 jane perfshire :

- **Asetet e reja** ne shumen 4.542 milion leke per vitin 2012, 2.687 milion leke per vitin 2013 dhe 2.204 milion leke qe priten te kapitalizohen per secilin vit respektiv. Verejme se ne propozimin e Shoqerise per llogaritjen e RAB-it per te gjithë periudhen e trete rregullatore nuk eshte zbatuar kerkesa sipas pikes 7.1 te Metodologjise se Llogaritjes se Tarifave per Kompanine Publike te Prodhimit, e cila parashikon.(perfshirja e investimeve te reja ne RAB me gjysmen e vleres se tyre).
- **Kosto e kapitalit (WACC)** eshte llogaritur sipas metodologjise dhe rezulton 6,09% per vitin 2012, 5,82% per vitin 2013 dhe 5,64% per vitin 2014 duke dhene nje kthim mbi asetin baze te rregulluar ne vlere absolute afersisht e barabarte me vleren 1,795 milion leke per vitin 2012, 1883 milion leke per vitin 2013 dhe 1844 milion leke per vitin 2014 te propozuar nga shoqeria.
- **Kapitali i punes** eshte llogaritur si 1/12 OPEX-it dhe pas korrigjimeve te bera pergjate analizes eshte korrigjuar ne zbritje dhe nga ky korrigjim rezulton 157 milion leke per vitin 2012, 164 milion leke per vitin 2013 dhe 173 milion leke per vitin 2014.

Te ardhurat totale te kerkuara per te mbuluar shpenzimet OPEX-it dhe CAPEX-it per vitin 2012-2014, sic paraqiten dhe ne tabelen me siper, llogariten ne shumen 3.361 milion leke per vitin 2012, 3.666 milion leke per vitin 2013 dhe 3.944 milion leke per vitin 2014.

Keto te ardhura te kerkuara sic verehen ne tabelen nr.4 do te korrigjohen :

- Ne rritje per shumen 596 milion leke per vitin 2012, per shkak te mosrealizimit te eksportiti te parashikuar per vitin 2011.

Duke reflektuar korrigjimet e mesiperme, te ardhurat e kerkuara te shoqerise KESH sha. per realizimin e aktivitetit te gjenerimit per vitin 2012-2014 jane

vleresuar mesatarisht ne shumen 3,856 milion leke, qe i korrespondojne nje tarife mesatare te prodhimit te energjise elektrike prej 1.00 leke /kWh

Tarifa mesatare e gjenerimit publik te KESH sh.a. e propozuar si me lart do te mundesoje nje situata financiare normale per realizimin e aktivitetit dhe arritjen e objektivave ekonomike nga ana e Shoqerise Publike te Prodhimit (KESH).

Energjia e planifikuar per t'u shitur/transferuar tek Furnizuesi Publik me Shumice dhe energjia e planifikuar per t'u shitur per humbjet tek Operatori i Sistemit te Transmetimit, do te realizohen sipas ketyre tarifave.

2.3 TARIFA E PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE PER TEC VLORE SH.A.

TEC Vlore sh.a., paraqiti aplikimin per çmimin e shitjes se energjise elektrike per vitin 2012 me ane te shkreses me Nr. 327, date 28.09.2011. Ky operator eshte licensuar per prodhimin e energjise elektrike nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me Vendim Nr 11 date 02.03.2009.

Gjate shqyrtimit te ketij aplikimi, per sqarimin dhe saktesimin e informacionit mbi elemente te shpenzimeve per zera te ndryshem eshte mbajtur nga ana jone korespondence me perfaqesues te TEC-Vlore nepermjet postes elektronike qe tashme eshte bere pjese e dokumentacionit te mbajtur per qellim te llogaritjes se tarifes per kete shoqeri. Ne komunikimin elektronik te dates 25.11.2011 eshte derguar aplikimi perfundimtar me disa korrigjime.

Te ardhurat e kerkuara nga shoqeria per vitin 2012 rezultojne 6,567milion leke per nje prodhim prej 245 GWh. Nisur nga keto te dhena rezulton qe cmimi mesatar (perfshire kostot fikse dhe variabile)i kerkuar nga shoqeria te jete 28.43 leke/kWh.

Duhet theksuar se ende nuk ka perfunduar faza e komisionimit te TEC-Vlore per shkak te problemeve te shfaqura ne sistemin e marrjes se ujit te ftohte dhe ne tubin e furnizimit me nafte. Nderkohe nga informacioni shtese i marre nga perfaqesuesit te shoqerise gjate shqyrtimit te aplikimit, rezulton se ne periudhen Gusht-Tetor eshte prodhuar gjithsej 59.6 GWh ne kuadrin e provave.

Realizimi i pritshem i shpenzimeve per vitin 2011 eshte raportuar ne shumen prej 2,938 milion leke, prej te cilave 1,308 milion leke jane shpenzime per lenden djegese, 94 milion leke per sherbimin e operim-mirembajtes (O&M) me kompanine fituese LUTHARDT ndersa pjesen tjeter e perbejne kryesisht shpenzimet per pagat e personelit dhe per shlyerjen e pagesave te interesit te

kredive. Theksojmë se, ndërsa një pjesë e këtyre shpenzimeve si për shembull shpenzimet për shërbimet O&M janë verifikuar, pjesa tjetër do të jetë objekt i monitorimit nga ana e ERE-s në momentin e mbylljes të kësaj periudhe financiare. Në tabelën në vijim, paraqiten në mënyrë të përmbledhur të dhënat për vitin 2011 sipas Vendimit të ERE-s për 2011 si dhe propozimet për vitin 2012 sipas aplikimit të shoqërisë dhe Grupit të Punes.

TERMOCENTRALI VLORE sh.a.

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	Vendimi i ERE-s për vitin 2011	Aplikimi i TEC-Vlore për vitin 2012	Propozimi i ERE-s për vitin 2012
1	Te dhena teknike				
	Fuqia e vendosur Neto	MW	97	97	97
2	Te dhena të Prodhimit dhe Konsumit				
	Gjenerimi Neto Vjetor	MWh/vit	140,179	245,552	72,000
	Konsumi vjetor i naftës gazoil 0.2 % (Diezel)	Ton/vit	25,078	52,179	12,888
3	Kosto Vjetore				
	Personeli	mil. Leke	55	75	55
	Amortizimi total	mil. Leke	339	674	794
	Lende Djegese	mil. Leke	2,166	5,068	1,490
	Axhustimi i L Djegese	mil. Leke	-2,166	49	-1,490
	Blerje materiale dhe produktesh	mil. Leke	15	199	16
	Fumitura dhe shërbime	mil. Leke	26	51	35
	O & M	mil. Leke	135	149	58
	LTSA	mil. Leke	81	121	94
	Te tjera (sigurim, publikime, pritje përcjellje)	mil. Leke	18	2	18
	Pagesat e interesit (Annuity of investment)	mil. Leke	874	414	505
	Axhustim i O&M dhe LTSA	mil. Leke	-202	223	-166
4	Kosto Totale Vjetore	mil. Leke	1,341	7,024	1,409

Lidhur me shifrat e paraqitura në këto tabele jepen sqarimet në vijim:

Llogaritja e prodhimit vjetor të energjisë elektrike

Në përcaktimin e sasisë së energjisë elektrike që duhet të prodhojë TEC i Vlores gjatë vitit 2011 janë patur në konsideratë :

- Faktin që pas komisionimit të centralit fillon periudha e garancisë. Vënia në punë e TEC-it do të tregonte edhe performancën e tij sipas Projektit, prandaj është e domosdoshme që TEC-i të punojë me ngarkesë mundësisht maksimale me qëllim që të evidentohen dhe të riparohen nga kompania kontraktuese të gjitha difektet që ai mund të ketë. Në këto kuader, Kontraktori do të përgjigjet për zgjidhjen e të gjithë problemeve të mbetura nga projekti që mund të shfaqen gjatë një operimi të vazhduar të tij.
- Duke u bazuar në fuqinë e centralit dhe duke punuar me ngarkesë të plote gjatë gjithë ditës, TEC-i mund të prodhojë rreth 2,400 MWh/dite. Nëse për një periudhë pune prej 30 ditë do të prodhohet nga TEC Vlore 72 GWh, kjo do thotë që jetëgjatësia e rezervës aktuale hidroenergetike të rritet ndjeshëm

duke bere mundur garantimin e hyrjes ne zonen e reshjeve me garanci te larte funizimi ne shkalle vendi per klientet fundore.

Per sa me lart, prodhimi per vitin 2012 nga TEC-Vlore parashikohet te jete 72 GWh.

Shpenzimet

Lidhur me shpenzimet duhet sqaruar se te gjitha zerat qe do te realizohen ne Euro si: kontrata afatgjate per mirembajtjen e turbinave te gazit e lidhur me kontraktuesit e (LTSA), marreveshja per operimin dhe mirembajtjen (O&M), shpenzimet qe kane te bejne me shlyerjen e interesave te kredive, etj eshte perdorur kursi i kembimit 140.75 Leke/ Euro. Ne menyre me analitike keto shpenzime paraqiten si vijon:

Kosto Personeli

Nga ana e shoqerisee kerkuar qe ky shpenzim te jete ne shumen 75 milion leke per nje numer te raportuar personeli prej 58 personash. Realizimi i pritshem i shpenzimeve per personelin paraqiten nga shoqeria ne vleren 58.6 milion leke ndersa deri ne qershor 2011 shpenzime faktike per personelin raportohet te jene 26.6 milion leke.

Nisur nga Plani i Biznesit (pjese e marreveshjes se PPA-se) si dhe duke marre parasysh qe TEC-i nuk do te punoje gjate gjithë vitit, grupi ipunes gjykon se numri i punonjesve duhet te vazhdoje te pranohet 48 persona dhe si rrjedhim shpenzimet per personelin te jene **54,8 milion leke** po aq sa u pranuan edhe ne Vendimin e ERE-s per vitin 2011.

Amortizimi

Meqenese shoqeria nuk ka marre ende ne dorezim objektin per shkak te voneses ne komisionim, nuk rezulton nje vlere e objektit e pasqyruar ne librat e llogarive, si rrjedhim kemi konsideruar vleren prej 112 milion Euro te projektit dhe nje jetegjatesi prej 20 vjetesh. Duke marre ne konsiderate edhe shumen prej 5 milion leke per amortizimin e investimeve te kryera nga shoqeria per punonjesit e saj (pajisjet kompjuterike dhe teknike) rezulton qe amortizimi per vitin 2012 te jete **793.5 milion leke**.

Lenda Djegese

TEC-Vlora sh.a. parashikon qe deri ne fund te vitit 2011 te konsumoje 1.3 milion leke per lenden djegese. Ne fakt, nga komunikimi elektronik rezulton qe per periudhen Gusht –Tetor 2011 jane prodhuar gjithsej 59.61 GWh me nje konsum mesatar specifik prej 182.1 kg/MWh. Sipas llogaritjeve te grupit te punes, vlere e

lendes djegese te konsumuar gjate 2011 (perfshire ketu edhe firot ligjore) rezulton te jete 860.7 milion leke.

Tabela ne vijim pasqyron levizjet per lenden djegese per periudhen 2009-2011:

Levizjet per lenden djegese (Liter)	Hyrje	Dalje	Firo Ligjore & Mungesa	Gjendja ne fund	Cmimi i blerjes (leke /Liter)
Viti 2009	18,654,796	1,660,000	3765	16,991,031	60.17
Viti 2010	4,951,904	7,784,886	7500	14,150,549	77.993
Viti 2011	-	12,922,813	9,612	1,218,123	

Nga tabela verehet qe nga sasia prej 23,606 mije litra blere ne vitet 2009 e 2010 per nje vlere prej 1,508.7 milion leke, gjendja ne fund te vitit 2011 eshte rreth 1,200 mije litra, e cila nisur edhe nga shpjegimi ne aplikim do te konsiderohet si lende djegese rezerve.

Duke pasur parasysh qe:


- Prodhimi i propozuar per vitin 2012 nga TEC-Vlore eshte 72 GWh.
- Konsumi specifik i lendes djegese eshte 178.994 kg/MWh

Rezulton qe sasia e lendes djegese qe nevojitet per vitin 2012 eshte 12, 888 ton (ose 15,342 mije litra).

Cmimi i blerjes se lendes djegese:

Per percaktimin e cmimit te lendes djegese per vitin 2012, TEC-Vlore sh.a. i referohet Buletinit te dates 19 shtator 2011 te Agjencise se Prokurimit Publik te dhenat e te cilit jane marre nga bursa Reuters e dates 15.09.2011. Nisur nga cmimi 960 \$/Ton per gazoil me 0.1% squfur dhe kursi i Bankes se Shqiperise i po kesaj dite USD=102.7 leke, rezulton nje cmim prej 97.12 leke/liter pa akcize.

Nisur nga fakti qe lenda djegese ze nje perqindje te konsiderueshme (rreth 80%) te totalit te te ardhurave te kerkuara, per percaktimin sa me te perafert me realitetin te cmimit te lendes djegese grupi i punes beri nje studim te tregut nderkombetar. Konkretisht ne faqen zyrtare te US Energy Information Administration krahasuam cmimet e muajit shtator ne tre tregjet (New York Harbor, U.S Gulf Coast dhe Los Angeles, CA) me ate te kuotuar ne buletin e APP, rezultoi qe cmimi i kuotuar nga APP eshte mesatarisht vetem 3 leke/liter me i larte se ai i kuotuar ne tregjet e siper cituara. Nderkohe nisur nga fakti qe cmimi i propozuar ne aplikim i takon nje periudhe te kaluar dhe nuk merr parasysh ndryshimet e mundeshme ne treg, grupi i punes u perpoq te gjej tendencat e cmimit per vitin 2012. Grafiku ne vijim pasqyron levizjen e cmimeve ne tregun U.S. Gulf Coast gjate periudhes 2006-2011 dhe ne menyre te vecante parashikimin per vitin 2012 ku verehet tendenca ne rritje e cmimit per gazoilin.



Eshte me interes ti kushtohet vemendje pjeses me ngjyre gri te grafikut (2008-2009) ku verehet nje paqendrueshmeri me tendence ne renie te theksuar te cmimit per shkak te recesionit ne SH.B.A.

Nderkohe meqenese behet fjale te parashikohet nje cmim per blerjen e lendes djegese ne nje periudhe te afert (te pakten ne tremujorin e pare te 2012) per shkak te gjendjes zero te sasise se lendes djegese qe rezulton ne fund te vitit 2011 dhe per asrye te pasigurise ne sakesine e parashikimit te cmimit te lendes djegese (situata ekonomike ne rajon) grupi i punes gjykon se duhet pranuar cmimin i propozuar nga TEC Vlore sh.a, pra 97.12 leke/liter. Nderkohe ERE mund te rishikojte kete shpenzim ne periudhen e ardheshme, ne momentin e pasjes se informacionit te sakte mbi cmimin e realizuar te blerjes se lendes djegese.

Si rezultat i sasise dhe cmimit te lendes djegese te pranuar si me lart, shpenzimi per lenden djegese per vitin 2012 parashikohet ne shumen 1,490 milion leke.

Ne vijim paraqesim nje analize te levizjes dhe gjendjes se fondit te parave per blerjen e lendes djegese: ERE ne Vendimin Nr 94 dt 15.12.2009 te Bordit te Komisionereve njohu ne tarifen e vitit 2010 nje shpenzim total prej 3,10.8 milion leke per lenden djegese, nderkohe qe ne vendimin per tarifen e vitit 2011, praktikisht ERE nuk akordoi asnje fond pasi TEC Vlore trashegoi nga vitit i meparshem vleften e pashpenzuar per lenden djegese.

Tabela ne vijim pasqyron levizjen te fondit te njohur nga ERE per lenden djegese

Levizjet e fondit per lenden djegese	Njesia	Vlera
Ne 2010 aprovuar nga ERE per 51713 mije litra	milion leke	3,102
Ne 2009 blere 18,654 mije Litra	milion leke	1,122
Ne 2011 dhene mije Leke	milion leke	
Ne 2010 blere 4951 mije litra	milion leke	386
Mbeten ne 31.12.2011	milion leke	1,593

Nga sa me lart verehet qe ne 31.12.2011, TEC-Vlore sh.a. rezulton te kete akoma nje rezerve prej 1,593 milion leke te njohura ne tarifen e vitit 2010, te mjaftueshme per te mbuluar kerkesen prej **1,490 milion leke** per lenden djegese per vitin 2012. Nisur nga ky fakt, Grupi i Punes propozon qe te behet axhustimi ne zbritje per te njejtën shume ne totalin e te ardhurave.

Nga shqyrtimi i Pasqyrave Financiare te vitit 2010 u konstatua se ne zerin II.6 "Aktive te tjera afatgjata (ne proces)" figuron nje vlere prej 963.9 milion leke. Lidhur me kete vlere shoqeria TEC Vlore sh.a. sqaron se vlere prej 39.9 milion leke eshte leja e ndertimit e paguar ne vitin 2009, ndersa pjesa tjeter "kosto e provave" eshte vlere e lendes djegese te shpenzuar.

Nisur nga ky informacion, ERE ka te drejten qe ne momentin e kapitalizimit, te behet korrigjimi per vleften e lendes djegese qe eshte dhene per periudhen 2010-2012.

Rezerva e lendes djegese

TEC-Vlore sh.a. ka kerkuar 48.6 milion leke per prokurimin e 500 mije litra per plotesimin e rezerves se lendes djegese. Sikurse u shpjegua edhe me perpara, kjo vlefte nuk perfshihet ne shpenzimet operative pasi eshte nje rezerve ne sasi fikse qe zevendesohet cdo vit nga sasia vjetore e lendes djegese ne rast se preket, nderkohe qe nisur nga bilanci i lendes djegese dhe i fondit te parave per lenden djegese ne piken 2.3 rezulton qe ky problem eshte mese i tejkasuar.

Blerje materialesh dhe produktesh

Nga TEC-Vlore sh.a. eshte propozuar qe per vitin 2012 ky ze shpenzimesh te jete 199.2 milion leke ku pjesen me te madhe e perben vlere prej 1,300 mije Euro ose 183.3 milion leke pjese nderimi te cilat nga verifikimi i kryer nga ana e grupit te punes jane perfshire ne vleften e projektit si element i vecante. Duke eliminuar kete shpenzim si dhe duke bere rregullimet e arsyeshme propozohet qe ky ze shpenzimesh te jete ne vleren 16.4 milion leke. Ketu perfshihen kryesisht 14.2 milion leke per blerje kimikatesh, 1.44 milion leke blerje karburanti per automjetet, 0.4 milion leke per kancelari dhe 0.4 milion leke per shpenzime mirembajtje.

Operim dhe Mirembajtje (O&M)

Ne date 12.08.2011 TEC-Vlore sh.a. ka lidhur kontraten 3-vjecare me vlere rreth 3 milion Euro per sherbimin e operim mirembajtje me firmen LUTHARDT, e shpallur fituese ne buletin e APP-se te dates 12.08.2011. Lidhur me kete kontrate, ne vijim paraqiten krahasimet me vlerat e parashikuara ne Planin e Biznesit (pjesa e marreveshjes se PPA-se) i cili reflekton eksperiencat dhe praktikat per TEC-e me te njejtat karakteristika si TEC-Vlora:

Kontratat O&M	P-B (Eur)			Kontrata e finalizuar (Eur)		
	Variabel	Fikse	Total	Variabel	Fikse	Total
Viti 2011	100,000	333,333	433,333	584,100	159,900	744,000
	493 GWh			245 GWh		
Viti 2012	100,000	500,000	600,000	959,970	133,070	1,093,040
	743 GWh			245 GWh		
Viti 2013	100,000	500,000	600,000	959,970	133,070	1,093,040
	743 GWh			245 GWh		
Totali Kontrata	300,000	1,333,333	1,633,333	2,504,040	426,040	2,930,080

Nga tabela verehet qe ne Planin e Biznesit vlera totale e kesaj kontrate per periudhen 3-vjecare parashikohej te ishte 1,63 milion Euro dhe per nje prodhim total prej 1,979 GWh. Verehet nje diference e konsiderueshme prej 1,29 milion Euro midis parashikimit ne Plan-Biznes dhe kontrates se finalizuar nga shoqeria. Kjo diference behet akoma edhe me e theksuar ne rast se do te marrin ne konsiderate edhe nivelin e reduktuar te prodhimit prej 735 GWh qe aktualisht TEC –Vlore planifikon te prodhoje ne periudhen 3-vjecare nga 1,819 GWh i parashikuar ne P-B. E theksojme kete diference te prodhimit per faktin se vlera e pjeses variabel e kontartes percaktohet ne baze te oreve te punes se centralit.

Pavaresisht kesaj analize, ne llogaritjet e shpenzimit per kontraten O&M ne vitin 2012 jemi bazuar ne kontraten e lidhur me LUTHARDT por duke bere korrigjimet per pjesen e kostos variabel. Nisur nga parashikimi i Grupit tet Punes qe TEC Vlora do te prodhoje 72 GWh, rezulton qe shpenzimet per kontraten O&M ne 2012 te jene 58.5 milion leke.

Aktualisht per vitin 2011, Shoqeria ka paguar dy fatura me nje vlefte totale prej prej 355,100 Eur (49.1 milion leke) ndryshe nga sa raportohet nga TEC-Vlore per realizimin e pritshem.

Tabela ne vijim jep nje pasqyre te levizjes se fondeve per kontraten O&M gjate periudhes 2010-2011:

Kontrata O&M (milion leke)	Fikse	Variable	Total
Tarifa 2010	32.1	35.4	67.6
Realizuar 2010	-	-	-
Axhustuar per 2010	(32.1)	(35.4)	(67.6)
Tarifa 2011	64.2	70.8	135.0
Realizuar 2011	(18.8)	(31.1)	(49.9)
Mbeten per tu axhustuar nga 2011	(45.4)	(39.7)	(85.1)
Kontrata O&M per 2012	18.7	39.7	58.5
Per tarifen e vitit 2012	(26.7)	0.1	(26.6)

Nga tabela vihet re se ne 2011 kane mbetur pa perdorur 85.1 milion leke, pra me teper nga sa nevojiten nga llogaritjet tona per vitin 2012 per kontraten O&M. Per kete arsye propozohet qe te korrigojohen ne zbritje te ardhurat e kerkuara per vitin 2012 me diferencen prej 26.6 milion leke.

Sherbimi i Turbinave te Gazit (LTSA)

Ky shpenzim eshte kerkuar per vitin 2012 ne vleren 121.5 milion leke. Sipas planit te biznesit te hartuar nga kompania konsulente ky shpenzim per komponentet fikse dhe variabel per vitin e pare te operimit per nje prodhim prej 72 GWh parashikohet te jene respektivisht 585,583 Euro dhe 745,134 Euro. TEC-Vlore ka perdorur keto vlera me te vetmin ndryshim qe ne llogaritjen e shpenzimit per komponentin variabel kane marre parasysh nje prodhim prej 245 GWh. Nisur nga keto te dhena, me korrigjimin per nje prodhim prej 72 GWh ne llogaritjen e komponentit variabel, rezulton nje shpenzim total per **93.9 milion leke** per kontraten LTSA ne vitin 2012.

Per te percaktuar te ardhurat e nevojshme per kontraten LTSA per vitin 2012 paraqiten ne vijim levizjet e fondeve te njohura ne tarifat e periudhes 2010-2011:

Kontrata LTSA (milion leke)	Fikse	Variable	Total
Tarifa 2010	76.4	57.7	134.1
Realizuar 2010	-	-	-
Tarifa 2011	46.0	34.7	80.8
Axhustuar per 2011	(76.4)	(57.7)	(134.1)
Realizuar 2011	-	-	-
Mbeten per tu axhustuar nga 2011	(46.0)	(34.7)	(80.8)
Kontrata LTSA 2012	82.4	11.5	93.9
Per tarifen e vitit 2012	36.4	(23.3)	13.1

Duke axhustuar per vleren prej 80.8 milion leke te shpenzuar ne vitin 2011, shuma neto e propozuar per kontraten LTSA eshte 13.1 milion leke.

Furnitura e sherbime

Ky ze eshte kerkuar ne vleren 50.8 milion leke dhe perfshin kryesisht shpenzime poste dhe telekomunikacioni, ruajtje objekti, pagat e Keshillit Mbikqyres, transport per punonjesit, riparim makinash, taksat lokale, etj. Mbas shqyrtimit me kujdes te ketij propozimi dhe duke bere disa axhustime te arsyeshme, propozohet qe ky ze shpenzimesh te jete ne vleren 35 milion leke.

Te tjera

Ketu parashikohen shpenzime per siguracione, publikimet e dokumentave te tenderit dhe pritje percjellje qe TEC-Vlora i propozon ne shumen 1.8 milion leke.

Sipas planit te biznesit te hartuar nga konsulentet e huaj eshte parashikuar qe siguracioni vjetor te jete ne shumen 607.2 milion leke. Per vitin 2011 ERE ka pranuar nje shifer prej 16.1 milion leke si me perfaqesuesja e tregut aktual shqiptar te sigurimeve. Grupi i punes propozon te pranohet e njejta shifer e paraqitur edhe per vitin 2012.

Nisur edhe nga realizimi i pritshem ne shumen 1.5 milion leke i shpenzimeve per publikime te vitit 2011, propozojme qe shpenzim e tjera per vitin 2012 te jete ne shumen **17.62 milion leke**.

Pagesat e interesit

Shuma e parashikuar nga shoqeria per kete ze prej 414.3 milion leke ka te beje me shlyerjen e kredive te marra nga Banka Boterore (BB), Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (E.B.R.D) dhe banka Europiane per Investime (E.I.B) per ndertimin e TEC-it .

Nisur nga plani i shlyerjes se kredive nga bankat e sipercituara rezulton qe per vitin 2012 vlera totale e interesave per te tre bankat eshte **505.2 milion leke**.

Verejme se ne aplikimin e KESH sh.a ne funksionin e tij si prodhues publik, kjo shume eshte perfshire ne totalin e kredive afatgjata ne fund te periudhes (pra kredite afatgjata per KESH Gen dhe TEC) si dhe kosto e borxhit per kete shoqeri eshte perfshire ne koston e kredise se shoqerise meme KESH sha.

Per arsye te llogaritjes tarifes fikse te TEC –Vlore, ky shpenzim per vitin 2012 alokohet ne te ardhurat e kerkuara te shoqerise duke bere ne te njejten kohe rregullimin ne zbritje te te ardhurave te kerkuarae te KESH sh.a. per periudhen e ardheshme rregullatore.

Investime per punonjesit.

Shoqeria ka planifikuar qe gjate vitit 2012 te kryeje 11.5 milion leke investime per te cilat nuk ka specifikime. Nisur nga analiza “ ne perdorim & te nevojshme ” do te gjykohet nese keto investime do te perfshihen ne te ardhmen ne bazen e asetëve dhe do te amortizohen sipas normave ne fuqi. Nderkohe duhet theksuar se ndryshe nga eksperienca e kaluar, shoqeria ne kete aplikim nuk i ka perfshire keto investime ne koston totale vjetore. Per sa me lart kjo shifer nuk eshte konsideruar nga ana e grupit te punes ne llogaritjet e te ardhurave te kerkuara.

Nga sa me siper rezulton qe te ardhurat e kerkuara per vitin 2012 per TEC-Vlore jane rreth 1,409 milion leke. Nga sa u trajtua lidhur me shpenzimet per lenden djegese si dhe pjesen variabile te shpenzimeve per kontratat O&M dhe LTSA te percaktuara per vitin 2012 (pavaresisht axhustimeve per shkak te fondeve te teperta

nga vitet 2010 e 2011), kosto variabile per njesi te prodhuar rezulton te jete 21.4 leke /kWh.

Ne perfundim Grupi i Punes propozon:

- Tarifa fikse per aktivitetin e prodhimit te TEC-Vlora sh.a. per vitin 2012 te jete **1,211 mije leke/MW/muaj**
- Tarifa variabel e shitjes se energjise tek KESH sh.a. te jete **21.4 leke/kWh**.

2.4 Cmimi i shitjes se energjise elektrike nga HEC Ulez & Shkopet sh.a., HEC Bistrice 1 Bistrice 2 sh.a.dhe HEC Lanabregas sh.a. per periudhen 2012-2014

HEC Ulez & Shkopet sh.a., HEC Bistrice 1 Bistrice 2 sh.a. dhe HEC Lanabregas sh.a. jane licensuar per prodhimin e energjise elektrike nga Bordi i Komisionereve te ERE-s respektivisht me Vendimet Nr. 132 datë 06.12.2011, Nr. 136 datë 06.12.2011 dhe Nr. 134 datë 06.12.2011. Keto shoqeri kane paraqitur ne ERE kerkesat per cmimin e shitjes se energjise elektrike per vitin 2012 te cilat po i trajtojme ne vijim:

Kerkesa e HEC Ulez & Shkopet sh.a.

HEC Ulez & Shkopet sh.a. operon HEC-et Ulez dhe Shkopet me fuqi totale te instaluar 49.2 MW te ndertuar ne kaskaden e lumit Mat.

Kjo shoqeri paraqiti aplikimin per çmimin e shitjes se energjise elektrike per vitin 2012 me ane te shkreses me Nr. 04 Prot, date 16.09.2011 e me pas e rishikoi kerkesen me ane te shkreses me nr 518/1 Prot Hyres, kerkesa te cilin e prezantoi gjithashtu ne Seancen Publike te dates 30.11.2012.

Shoqeria kerkon 769 milion leke te ardhura per vitin 2012 per nje prodhim prej 165 GWh nga ku rezulton nje cmim i kerkuar prej 4.65 leke/kWh. Veme ne dukje qe viti 2012 eshte viti i pare i operimit si shoqeri me vete e si rrjedhim mungon eksperienca ne parashikimin e te ardhurave .

Nisur nga fakti qe keto HEC-e kane qene ne pronesi te KESH sh.a. dhe ne aplikimin per tarife me Nr. 483 e dates 31.08.2012 te KESH sh.a. jepet informacion analitik mbi kerkesat per te ardhura secilen njesi gjeneruese, ne percaktimin e tarifes per kete shoqeri kemi bere krahasimin e kerkesave nga HEC Ulez & Shkopet sh.a. dhe KESH sh.a. Nisur nga kjo analize dhe disa sakesime

nga ana jone ne vijim po paraqesim propozimin e grupit te punes per HEC Ulez & Shkopet sh.a:

HEC Ulez&Shkopet sh.a.

Emertimi	Njesia e matjes	Aplikimi i Ulez&Shkopet	Sipas aplikimit te KESH per 2012	Propozim i IERE-s
Kapaciteti Total	MW	49.2	49.2	49.2
HEC Ulez	MW	25.2	25.2	25.2
HEC Shkopet	MW	24	24	24
Mirembajtje	mil. leke	46	46	46
Personeli	mil. leke	181	160	169
Furnitura e sherbime	mil. leke	60	5	50
Totali OPEX	mil. leke	287	211	265
Vlera e Aseteve	mil. leke	2622	2601	2263
Amortizimi i akumuluar	mil. leke	643	594	594
Vlera neto e asetëve	mil. leke	1979	2007	1669.29
Kapitali i punes	mil. leke	24	18	22
Investime	mil. leke	407	408	407
Amortizimi i vitit	mil. leke	70	66.6	70
Lik. Borxhi ndaj KESH krijuar 2011	mil. leke			
Baza e Rregulluar e Aseteve	mil. leke	2340	2229	1895
WACC	mil. leke	6.09%	6.09%	6.09%
Fitimi	mil. leke	143	136	115
Te ardhura te kerkuara neto	mil. leke	769	413	451
Energji e Prodhuar	GWh	165	165	165
Tarifa mesatare e Prodhimit	leke/kwh	4.65	2.50	2.72

Per sa me lart sqarojme:

Shpenzimet operative parashikohen ne shumen 265 milion leke duke u bazuar ne pergjithesi ne planifikimin e KESH sh.a. per vitin 2012 por duke marre parasysh disa shpenzime shtese qe rrjedhin si rezultat i administrimit me vete mbas shkeputjes nga KESH;

Ne percaktimin e shpenzimeve per personelin ne shumen 169 milion leke kemi marre parasysh rritjen vjetore te pages mesatare prej 4% si dhe 2.3 milion leke pagesa per Keshillin Mbikqyres.

Ne llogaritjen e zerit "Furnitura dhe sherbime" ne vleften 50 milion jane marre parasysh gjithashtu shpenzimi per sherbimin e ruajtjes se objekteve ne mbeshtetje te akt-marreveshjes qe shoqeria ka lidhur me "KESH Security" SH R S F sh.a. per vitin 2012 ne shumen 40.4 milion leke si dhe shpenzimi per sigurimin e objekteve ne shumen 6.1 milion leke (0.27% e vleres se asetëve)

Ne percaktimin e Bazes se Rregulluar te Aseteve jemi bazuar ne:

Vleftat e parashikuara te asetëve dhe amortizimit te akumuluar ne 31.12.2011 qe rezultojne ne dokumentacionin e paraqitur nga KESH sh.a ne aplikimin per tarife

per periudhen 2012-2014 si dhe jane marre parasysh shitesat e asetëve ne vleften 48.29 milion leke mbas dates 31.08.2011 te raportuara nga HEC Ulez & Shkopet sh.a.

Investimet e propozuara ne vleften 407 milion perfshihen ne llogaritjet per tarife bazuar ne vendimin Nr. 142 dt07.12.2011 te Bordit te Komisionereve te ERE-s "Per shqyrtimin e aplikimit te shoqerise HEC Ulez&Shkopet sh.a per miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2012"

Nisur nga totali i te ardhurave te kerkuara qe rezulton ne shumen 451 milion leke, dhe niveli i prodhimit prej 165 GWh propozojme qe **cmimi i shitjes se energjise elektrike nga HEC Ulez & Shkopet sh.a. per vitin 2012 te jete 2.72 leke kWh.**

Kerkesa e HEC Bistrica 1 Bistrica 2 sh.a.

HEC Bistrica 1 Bistrica 2 sh.a. operon HEC-et Bistrica 1 dhe Bistrica2 te ndertuar mbi lumin Bistrice respektivisht ne vitet 1965 dhe 1966 me fuqi totale te instaluar 27.5 MW.

Kjo shoqeri paraqiti aplikimin per çmimin e shitjes se energjise elektrike per vitin 2012 me ane te shkreses me Nr.05.Prot, date 20.09.2011. Cmimi i kerkuar nga HEC Bistrica 1, Bistrica 2 sh.a. eshte 2.46 leke/kWh nisur nga nje nivel te ardhurash te kerkuara prej 382 milion leke dhe prodhim vjetor 155 GWh.

Ne shqyrtimin e kesaj kerkese, ashtu sic u sqarua edhe me lart jemi bazuar ne aplikimin e KESH sh.a. te dates 31.08.2012 nisur nga experienca shumevjecare ne menaxhimin e ketyre HEC-eve. Ne tabelen ne vijim jepen te dhenat nga aplikimi i HEC Bistrica 1 Bistrica 2 sh.a., KESH sh.a. si dhe propozimi i grupit te punes.

HEC Bistrica 1. Bistrica 2 sh.a.

Emertimi	Njesia e matjes	Aplikimi i Bistrica 1-2	Sipas aplikimit te KESH per 2012	Propozimi i ERE-s per 2012
Kapaciteti Total	MW	27.5	27.5	27.5
HEC Bistrica 1	MW	22.5	22.5	22.5
HEC Bistrica2	MW	5	5	5
Mirembajtje	mil. leke	18	10	10
Personeli	mil. leke	93	75	80.3
Furnitura e sherbime	mil. leke	53	4	33
Totali OPEX	mil. leke	164	89	123.3
Vlera e Aseteve	mil. leke	2650	2650	2650
Amortizimi i akumuluar	mil. leke	516	516	516
Vlera neto e asetëve	mil. leke	2134	2124	2134
Kapitali i punes	mil. leke	14	7	10
Investime	mil. leke	144	65	144
Amortizimi i vitit	mil. leke	83	83	83
Baza e Rregulluar e Aseteve	mil. leke	2209	2164	2216
WACC	mil. leke	6.09%	6.09%	6.09%
Fitimi	mil. leke	135	129	135
Te ardhura te kerkuara neto	mil. leke	382	301	341
Energji e Prodhuar	GWh	155	153	155
Tarifa mesatare e Prodhimit	leke/kwh	2.46	1.97	2.20

Per sa me lart sqarojme:

Shpenzimet operative propozohen ne shumen 123.3 milion leke bazuar ne planifikimin e KESH sh.a. per vitin 2012 dhe ashtu sic shpjeguam me lart kemi marre parasysh disa shpenzime shtese qe vijne si rezultat i administrimit me vete te shoqerise mbas shkeputjes nga KESH sh.a:

Ne percaktimin e shpenzimeve per personelin ne shumen 80.3 milion leke kemi aplikuar shtese per rritjen vjetore te pages mesatare prej 4% si dhe 2.3 milion leke per pagesen e Keshillit Mbikqyres.

Ne llogaritjen e zerit "Furnitura dhe sherbime" ne vleften 33 milion jane marre parasysh gjithashtu shpenzimi per sherbimin e ruajtjes se objekteve nga KESH Security ne shumen 23 milion leke si dhe shpenzimi per sigurimin e objekteve ne shumen 6 milion leke.

Investimet e propozuara ne shumen 144 milion perfshihen ne llogaritjet per tarife bazuar ne vendimin Nr.140 dt 07.12.2011 te Bordit te Komisionereve te ERE-s "Per shqyrtimin e aplikimit te shoqerise HEC Bistrica 1 Bistrica 2 sh.a. per miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2012".

Ne percaktimin e Bazes se Rregulluar te Aseteve jemi bazuar ne vleftat e parashikuara te asetëve dhe amortizimit te akumuluar ne 31.12.2011 qe rezultojne

ne dokumentacionin e paraqitur nga KESH sh.a ne aplikimin per tarife per periudhen 2012-2014

Si rezultat, totali i te ardhurave te kerkuara propozohet ne shumen 341 milion leke, ndersa niveli i prodhimit pranohet ai i parashikuar nga shoqeria 155 Gwh. Perfundimisht, propozojme qe cmimi i shitjes se energjise elektrike nga HEC Bistrica 1 Bistrica 2 sh.a. per vitin 2012 te jete 2.20 leke kWh.

Kerkesa e HEC Lanabregas sh.a.

HEC Lanabregas sh.a. operon HEC-in e Lanabregasit me fuqi te instaluar 5 MW. Kjo shoqeri ka aplikuar per çmimin e shitjes se energjise elektrike per vitin 2012 me ane te shkreses me Nr.470 Prot, date 23.09.2011. Cmimi i kerkuar eshte 6.6 leke/kWh per nje nivel te ardhurash te kerkuara prej 271 milion leke dhe nje prodhim vjetor 41 GWh.

Ashtu si per dy shoqerite e siperpermendura edhe per shqyrtimin e kerkeses se HEC Lanabregas sh.a. jemi bazuar ne aplikimin e KESH sh.a te Nr. 483 e dates 31.08.2012 nisur nga experience e saj shumevjecare ne menaxhimin e ketij HEC-i. Ne tabelen ne vijim jepen te dhenat nga aplikimi i HEC Lanabregas sh.a., KESH sh.a. si dhe propozimi i grupit te punes.

HEC Lanabregas sh.a.

Emertimi	Njesia e matjes	Aplikimi i Bistrica 1 Bistrica 2	Sipas aplikimit te KESH per 2012	Propozimi i ERE-s per 2012
Kapaciteti Total	MW	5		
HEC Lanabregas	MW	5		
	MW			
Mirembajtje	mil. leke	11	6	6
Personeli	mil. leke	75	78	78
Furnitura e sherbime	mil. leke	170	156	156
Totali OPEX	mil. leke	256	240	240
	mil. leke			
Vlera e Aseteve	mil. leke	180	238	160
Amortizimi i akumuluar	mil. leke	62	79	53
Vlera neto e aseteve	mil. leke	118	159	107
Kapitali i punes	mil. leke	21	20	20
Investime	mil. leke	24	0	24
Amortizimi i vitit	mil. leke	7	10	7.6
Baza e Rregulluar e Aseteve	mil. leke	144	179	139
WACC	mil. leke	6.09%	6.09%	6.09%
Fitimi	mil. leke	8.78	11	8
Te ardhura te kerkuara neto	mil. leke	271	261	256
Energji e Prodhuar	GWh	41	41	41
Tarifa mesatare e Prodhitimit	leke/kwh	6.6	6.36	6.25

Lidhur me llogaritjet tona sqarojme :

Shpenzimet operative i propozojme te jene 256 milion leke aq sa eshte planifikimi i KESH sh.a. Pjesen me te madhe te shpenzimeve operative e perben pagesa e tarifes se perdorimit te ujit qe ne baze te pikes a. te Vendimit Nr. 12 date 15.03.2010 te Komisionit Kombetar Rregullator te Ujit eshte 5 leke/m³ per HEC Lanabregas qe do te thote 3.6 leke eshte shpenzimi i ujit per prodhimin e 1kWh.

Investimet e propozuara ne shumen 24 milion HEC Lanabregas sh.a. perfshihen ne llogaritjet per tarife bazuar ne vendimin Nr dt te Bordit te Komisionereve te ERE-s "Per shqyrtimin e aplikimit te shoqerise HEC Lanabregas sh.a per miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2012".

Niveli i te ardhurave te kerkuara rezulton 256 milion leke per nje prodhim vjetor 41 GWh. Ne perfundim propozojme qe cmimi i shitjes se energjise elektrike nga HEC Lanabregas sh.a. per vitin 2012 te jete 6.25 leke kWh.

2.5 TARIFA E SHERBIMIT TE SHITJES ME SHUMICE TE ENERGIJISE ELEKTRIKE NGA FPSH

Perllogaritjet e tarifes nga ana e Furnizuesit Publik me Shumice (FPSH-se) jane bere duke marre ne konsiderate parashikimet me te fundit te treguesve tekniko financiare per vitin 2011 si dhe nevojen per te ardhura per periudhen e trete rregullatore 2012-2014, me qellim realizimin e detyrimit paresor, sigurimin e energjise elektrike per te siguruar furnizim te mjaftueshem per Furnizuesin Publik me Pakice.

KESH sh.a ne funksionin e tij si Furnizues Publik me Shumice ka paraqitur kerkesen etij bazuar ne:

1. Axhustimin e te ardhurave per periudhen aktuale te vitit 2011
2. Llogaritjen e kerkeses per te ardhura per periudhen e trete rregullatore 2012-2014 bazuar ne sigurimin e energjise elektrike sipas parashikimit te energjise elekteike per shitje te paraqitur nga CEZ Shperndarje sh.a.

Axhustimi(rillogaritja) i te ardhurave te pritshme per vitin 2011.

Bazuar ne germen (f) pika 5.1 te Metodologjise se llogaritjes se tarifave per furnizuesin Publik me Shumice rillogaritja e te ardhurave per periudhen aktuale do te rregullohen ne periudhen pasardhese te rregullimit, kjo per shkak te energjise

aktuale te blere per tu livruar klienteve tarifore si dhe kostove te blerjes se energjise elektrike, kundrejt asaj te parashikuar (per njesi- kWh),

Tabela 6. paraqet rillogaritjet e kostove dhe tarifes perkatese per Furnizuesin Publik me Shumice (FPSH) per vitin 2011.

Zeri	2011	2011.1
Blere energji nga Prodhuesi Publik	4,046	3748
Cmimi I prodhimit te energjise elektrike -lek	0.63	0.63
Kosto Totale e Prodhimit Publik-(000 leke)	2,541	2,361
Imortet e Energjise -GWh	-	681
Kosto e Importit - leke/kWh	-	8.46
Kosto totale e importit	-	5761
Blerje energjie nga PVE- GWh	165	127
Cmimi I PVE - leke/kWh	7.10	7.37
Kosto Totale e PVE- 000 leke	1,172	936
Blerje energjise nga TEC-Vlore-GWh	24	51
kosto e TEC-Vlore leke/kWh	16.00	16.00
Kosto Totale e TEC -Vlore- 000 leke	384	816
Blerje energjie nga IPP ndare		
Cmimi I PVE - leke/kWh		
Kosto Totale e PVE- 000 leke		-
Kosto Totale e Energjise -000leke	4,097	9,874
Shpenzime per personelin	32	32
Materiale	2	2
Furnitura e Sherbime	8	8
Shpenzime per interesa	772	862
Kosto fikse TEC-Vlore	1,341	1,341
Totali I te Ardhurave te Kerkuara	6,252	12,119
Marzhi I Fitimit ((0.5% e te ardhurave te ke	27	56
Kompensim per rillogaritjen e te ardhurave		
te FPSH per vitin 2011		
kompesim I te ardhurave nga eksporti I		
2010		
rillogaritje/kompesim ie te ardhurave nga		
TEC vlore		
Totali I te Ardhurave te Kerkuara-000 leke	6,279	12,176
Energji e shitur	4,235	4607
Tarifa e FPSH-se leke/kWh	1.48	2.64

Sic duket qarte dhe nga tabela e mesiperme, korrigjimet e kryera nga grupi i punes ne lidhje me te ardhurat e kerkuara nga FPSH konsistojne ne:

- Korrigjimin e sasise se energjise elektrike dhe tarifes per sasine e energjise se blere nga Prodhuesi Publik(KESH) prej 3748 GWh nga ai i llogaritur 4046 GWh, si pasoje e eksportit te energjise gjate periudhes Janar-Shkurt 2011 per 232 GWh si dhe reduktimit te sasiae qe pritet te prodhohet nga Gjenerimi Publik per 71 GWh (nga 4271 GWh te llogaritur ne 4200GWh sic parashikohet ne Deklaraten Regullatore)
- Rillogaritje e te ardhurave te kerkuara si pasoje e rritjes se energjise elektrike te parashikuar qe te blihet nga TEC-Vlore per sasine 27 GWh
- Korrigjimin i sasise se energjise qe pritet te blihet si dhe te cmimit te energjise te blere nga hidrocentralet e vegjel me kapacitete deri ne 15 MW per shumen 132 milion leke si me poshte:
 - Sasia e energjise axhustuar nga 165 GWh ne 127 Gwh qe pritet te realizohet.
 - Cmimi i blerjes rillogaritet nga 7.1 leke/kWh ai i miratuar per vitin 2010 ne 7.37 leke te miratuar per vitin 2011.
- Sasia e energjise elektrike te importuar qe pritet te realizohet per rreth 681 GWh , si pasoje e rritjes se kerkeses per energji elektrike nga ajo e parashikuar nga Furnizuesi Publik me Pakice.
 - $681 \text{ GWh} \times 8.46 \text{ leke/kWh} = 5,758 \text{ milion leke}$
- Rillogaritja e marzhit te fitimit ne rritje prej 28 milion leke, si efekt i ndryshimit te blerjes vjetore te energjise elektrike.
- Rillogaritja e kostove per mbulimin e interesave te kredive afatshkurta per mbulimin e kostove te paparashikuara per blerjen e energjise elektrike nga importi si dhe rinegocimi i overdrafetve per shumen 90 milion leke, (862 milion leke-772 milion leke).

Si perfundim te ardhurat e FPSH per vitin 2011 propozon te korigjohen me rritje per shumen 5,893 milion leke.

Llogaritja e tarifës së furnizuesit Publik me Shumicë për periudhën 2012-2014

Te ardhurat e kerkuara nga KESH sha., në funksionin e tij si furnizues me shumicë i energjisë elektrike, për vitet 2012-2014 llogariten duke marrë parasysh :

- Kerkesën për berje energjie të barabartë me atë kerkuar nga CEZ shpërndarje si furnizues me pakicë .
- Operimin e TEC –Vloje për 246 GWh
- OPEX –in për realizimin e aktivitetit të furnizimit me shumicë

Tabela.7 “Llogaritjet e kostove dhe tarifave perkatese per Furnizuesin Publik me Shumice (FPSH) per vitet 2012-2014.

Zeri	Propozuar ERE			Aplikuar KESH (FPSH)		
	2012	2013	2014	2012	2013	2014
Blere energji nga Prodhuesi Publik	3,611	3,609	3,610	3,974	3,900	3,880
Cmimi I prodhimit te energjise elektrike -leke/kWh	1.03	0.96	1.03	0.80	0.85	0.91
Kosto Totale e Prodhimit Publik-(000 leke)	3,724	3,448	3,711	3,166	3,329	3,530
Imortet e Energjise -GWh	0	33	193	938	1,164	1,196
Kosto e Importit - leke/kWh	8.02	8.02	8.06	8.02	8.02	8.06
Kosto totale e importit	0	265	1,556	7,523	9,335	9,640
Blerje energjie nga PVE- GWh	228	270	280	261	270	280
Cmimi I PVE - leke/kWh	8.10	8.30	8.20	7.86	7.84	7.83
Kosto Totale e PVE- 000 leke	1,847	2,241	2,296	2,051	2,117	2,192
Blerje energjise nga TEC-Vlore-GWh	72	0	0	246	246	390
kosto e TEC-Vlore leke/kWh	21.41			13.68	14.22	13.98
Kosto Totale e TEC -Vlore- 000 leke	1,541	0	0	3,365	3,498	5,452
Blerje energjie nga IPP ndare	200.00	363.00	363.00			
Cmimi I PVE - leke/kWh	3.14	3.14	3.14			
Kosto Totale e PVE- 000 leke	628.00	1,139.82	1,139.82			
Kosto Totale e Energjise -000leke	7,740	7,094	8,702	16,106	18,279	20,815
Shpenzime per personelin	31	31	32	31	31	32
Materiale	2	2	2	2	2	2
Furnitura e Sherbime	8	9	9	8	9	9
Shpenzime per interesa	848	848	848	848	848	848
Kosto fikse TEC-Vlore	1,409	1,500	1,500	3,982	3,982	5,483
Totali I te Ardhurave te Kerkuara	10,038	9,483	11,094	20,977	23,151	27,189
Marzhi I Fitimit (0.5% e te ardhurave te kerkuara)	46	43	51	100	111	131
Kompensim per rillogaritjen e te ardhurave te FPSH per vitin 2011	5,200		697			
kompesim I te ardhurave nga eksporti I vitit 2010	-2,050	1,200	2,100			
rillogaritje/kompesim ie te ardhurave nga TEC vlore	-1,541					
Totali I te Ardhurave te Kerkuara-000 leke	11,693	10,726	13,942	21,077	23,262	27,321
Energji e shitur	4,111	4,275	4,446	5,419	5,580	5,745
Tarifa e FPSH-se leke/kWh	2.84	2.51	3.14	5.82	4.17	4.75

Grupi i punes nga analiza e bere kerkeses per energji per tu shitur per klientet tarifoze, ka reduktuar kerkesen nga 5.419 GWh ne vitin 2012 ne 4.111GWh ne vitin 2014, ne 4,275 GWh per vitin 2012 dhe ne 4,275 GWh per vitin 2014, sipas aresyetimeve te bera ne piken 1..te relacionit "Bilanci i energjise elektrike".

Ky reduktim kerkeses shoqerohet me reduktim te operimit te Tec Vlore per 174 GWh si dhe reduktimin e energjise elektrike te importuar. Furnizimi i klienteve tarifoze per vitin 2012 mund te realizohet vetem me energjine e prodhuar ne vend, nga prodhimi publik ,nga HEC-et private deri ne 15 MW apo dhe nga HEC-et te ndara se fundi nga KESH sh.a.

Ne lidhje me shpenzimet operative, propozohet qe te pranohen kerkesat e kompanise, meqenese keto shpenzime jane pothuajse te njejta me ato te miratuara per tarifen e vitit 2011.

Ne te ardhurat e kerkuara per vitin 2012-2014 konsiderohen si te aresyeshme shuma 848 milion leke qe perfaqesojne kostot per mbulimin e kredive afatgjata te marra nga KESH sh.a per importin e energjise elektrike ashtu sic u konstatu edhe nga monitorimi i kryer per kete qellim ne KESH sh.a

Te ardhurat e kerkuara per vitin 2012 sic shihet dhe nga tabela nr.7 jane korrigjuar:

- Ne rritje per shumen 5,897 milion leke qe perfaqeson diferencen e te ardhurave te rillogaritura per FPSH per vitin 2011.
- Ne zbritje per shumen 1,541 milion leke , shume e cila perfaqeson te ardhurat e dhena ne tarifen e prodhimit te energjise elektrike per vitin 2010-2011 per TEC Vlore dhe qe per pasoje te mos realizimit te prodhimit ne sasine e palnifikuar prej 246 GWh mbetet rezerve tek FPSH-ja.
- Nga pasqyrat financiare te shoqerise per vitin 2010 rezulton te jene realizuar te ardhura nga shitja e energjise dhe te ardhura te tjera shtese per shumen 26 miliard leke kundrejt 6,8 miliard leke te njohura nga ERE si te aresyeshme dhe qe permbushnin nevojat e kompanise per te operuar ne kushte normale. Ne zbatim te Modelit Shqiptar te Tregut kjo diference midis te ardhurave faktike te realizuara dhe atyre te miratuar, eshte lene nga ana e ERE-s si rezerve (fond ballancimi) per te perballuar importet e energjise elektrike nga KESH sha. per vitin 2011 ose do te mbetet e pa axhustuar si rezerve deri ne mbylljen e plote te saj per periudhat e

ardheshme rregullatore. Per kete arsye nese do te bejme nje permbledhje te te ardhurave te mbetura si rezerve nga eksporti te vitit 2010 ato do te rezultonin :

- Te ardhura nga eksporti GWh x (+) =16,600 milion leke
- Tatim mbi te ardhurat 10% (-) = 1,600 milion leke

- Diferenca per tu kompesuar =15,000 milion leke

Per te realizuar nje rezerve per realizimin e blerjes se energjise elektrike per shitje tek klientet tarifore, propozohet qe nga eksporti i realizuar per vitin 2010 te zbritet vetem pjesa e te ardhurave shtese per 2,050 milion leke, shume kjo qe do te mbuloje rillogaritjet e bera sa me siper per tarifen e FPSH per vitin 2011, shume e cila nga ana e grupit te punes parashikohet te kompesohet ne vitet pasardhese per te perballuar riskun hidrologjik , ne zbatim te modelit shqiptar te tregut.

Duke marre ne konsiderate te gjitha korrigjimet e mesiperme, propozohet qe te ardhurat e kerkuara mesatare te FPSH per periudhen 2012-2014 te jene 12,120milion leke dhe nderkohe tarifa mesatare per kete periudhe per aktivitetin e furnizimit me shumice do te rezultojte 2.83 leke /kWh:

2.6 TARIFA E SHERBIMIT TE TRANSMETIMIT PER OST SH.A.

Llogaritja e tarifes se transmetimit te energjise elektrike eshte bazuar ne metodologjine perkatese te miratuar nga ERE dhe eshte mbeshtetur ne analizen e kerkesave per te ardhura te paraqitur ne aplikimin e OST sh.a te dates 2.09.2011.

Kerkesa per te ardhura te OST sh.a eshte trajtuar ne dy pjese :

- a) Korrigjimi i te ardhurave te kerkuara per vitin 2011
- b) Percaktimi i kerkeses per te ardhura per periudhen 2012-2014

Korrigjimi i te ardhurave te kerkuara per vitin 2011

Pas korigjimeve ne bilancin energjistik sipas pikes I te relacionit, jane bere korigjimet perkatese ne llogaritjen e tarifes se OST sh.a per vitin aktual 2011 si me poshte:

- Axhustim i zerit “blerje energji per humbjet si pasoje e axhustimit te sasise se levruar ne sistemin e transmetimit si edhe te cmimit te prodhimit te KESH sh.a si eshte permendur tek llogaritja e tarifes se prodhimit publik.e ketij relacioni.

Si rezultat i korigjimeve te mesiperme tarifa e transmetimit te energjise elektrike per vitin 2011 rezulton 0.53 leke /kWh nga ajo e miratuar 0.6 leke/kWh, pra me nje ulje prej 10 %

Te ardhurat e teperta te kompanise per vitin 2011, ne shumen prej 450 milion leke te cilat perfaqesojne diferencen e te ardhurave nga sasia e shitur si dhe te ardhurave nga alokimi i kapaciteteve, do te kompesohen ne periudhen pasardhese rregullatore.

Tabela nr.3 ne vijim paraqet kostot dhe rivleresimet e tarifes te transmetimit te energjise elektrike per OST sh.a per vitin 2011.

Zeri	2011.1	2011
Mirembajtje	350	350
Personeli	858	858
Blerje energji per humbjet	172	141
Pagesa per cdemtime shtepie/interesa		
Furnitura dhe Shpenzime	350	350
Totali i OPEX	1,730	1,699
Vlera e asetëve	16,836	16,836
Vlera kontabel 1 Janar 2010		
Vlera e investimeve te bera 2010		
Vlera e investimeve te parashikuara 2011	5,968	5,968
Vlera e investimeve te parashikuara 2012 (1/2)		
Vlera e investimeve te parashikuara 2013 (1/2)		
Vlera e investimeve te parashikuara 2014 (1/2)		
Minus Grantet	(517)	(517)
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2011	(5,209)	(5,209)
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2012		
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2013		
Amortizimi i pritshem 2012		
Amortizimi i pritshem 2013		
Amortizimi i pritshem 2014		
Vlera Neto e Asetëve	11,110	11,110
Kapitali I Punes	144	142
Baza e Rregulluar e Asetëve (RAB)	17,222	17,220
Kthimi i Lejuar mbi Kapitalin	8%	8%
Raporti i Synuar I Kapitalit te Vet	40%	40%
Kosto Mesatare e borxhit	4%	4%
Raporti i Synuar I Borxhit	60%	60%
WACC	5.68%	5.68%
Kthimi mbi RAB	978	978
Kompensim alokim kapaciteti + kompensim 2011	(70)	
kompesim I Ardhurave Kerkuara per vitin v2011		
Amortizimi i vitit	972	972
Tatali i te Ardhurave te Kerkuara	3,610	3,649
Energjia e levruar ne transmetim -MWh	6,762	6,082
Tarifa Mesatare e Transmetimit (leke/kWh)	0.53	0.60

Percaktimi i kerkeses per te ardhura per periudhen e trete rregullatore 2012-2014

Kerkesa e OST sh.a. permbante nje nivel te ardhurash te kerkuara prej 4,643 milion leke per vitin 2012, te ciles i korespondonte nje tarife mesatare per sherbimin e transmetimit prej 0.734 leke/kWh, pra nje rritje prej 22.3 % krahasuar me tarifen aktuale 0.6 leke/kWh.

Ne aplikimin e tyre, domosdoshmeria per nje tarife te re vjen si rezultat i kapitalizimit te kredive te perfunduara dhe saktesimit te detyrimeve qe ka OST per pagesen e interesit dhe principalit per kredite e vjetra dhe per kredite ne implementim.

Tabela ne vijim paraqet ne menyre te permbledhur kerkesen per te ardhura te shoqerise per periudhen 2012-2014.

Tabela 6 Kerkesa per te ardhura nga OST sh.a per periudhen 2012-2014 (000 leke)

Zeri	Propozuar ERE			Aplikuar nga OST		
	2012	2013	2014	2012	2013	2014
Mirembajtje	185	192	199	185		
Personeli	986	1,023	1,062	986		
Blerje energji per humbjet	233	218	233	256		
Pagesa per cdemtime shtepie/interesa				280		
Furnitura dhe Shpenzime	500	519	538	500		
Totali i OPEX	1,904	1,952	2,032	2,207		
Vlera e asetëve				26,436		
Vlera kontabel 1 Janar 2010	13,954	13,954	13,954			
Vlera e investimeve te bera 2010	1,861	1,861	1,861			
Vlera e investimeve te parashikuara 2011	10,900	10,620	10,620			
Vlera e investimeve te parashikuara 2012 (1/2)	4,500	9,000	9,000	9,000		
Vlera e investimeve te parashikuara 2013 (1/2)		1,800	3,600		3,600	
Vlera e investimeve te parashikuara 2014 (1/2)			3,240			6,480
Minus Grantet	-484	-460	-436	-484	-460	-436
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2011	-4,797			-4,797		
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2012		-5,782			-5,779	
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2013			-6,684			-6,681
Amortizimi i pritshem 2012	-985			-985		
Amortizimi i pritshem 2013		-902				
Amortizimi i pritshem 2014			-872			
Vlera Neto e Aseteve	24,949	30,091	34,283	25,338		
Kapitali I Punes	159	163	169	184		
				4,755		
Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)	25,108	30,254	34,452	26,578		
Kthimi i Lejuar mbi Kapitalin	8%	8%	8%	7.67%		
Raporti i Synuar I Kapitalit te Vet	40%	40%	40%	40.00%		
Kosto Mesatare e borxhit	3%	3%	3%	3.44%		
Raporti i Synuar I Borxhit	60%	60%	60%	60.00%		
WACC	5.47%	5.47%	5.47%	5.47%		
Kthimi mbi RAB	1,374	1,656	1,886	1,455		
Kompensim alokim kapaciteti + kompensim 2011		(200)	(800)			
kompesim I Ardhurave Kerkuara per vitin v2011	(450)					
Amortizimi i vitit	985	902	872	985		
Totali i te Ardhurave te Kerkuara	3,813	4,309	3,990	4,643		
Energjia e levruar ne transmetim -MWh	6,222	6,158	6,171	6,327		
Tarifa Mesatare e Transmetimit (leke/kWh)	0.61	0.70	0.65	0.734		

Elementet e OPEX-itZeri Mirembajtje

Parashikimi i zerit mirembajtje per vitin 2012 ka ulje ne krahasim me ate te vitit 2011 duke u nisur nga realizimi i ulet per 2 vitet e fundit si edhe nga venia ne operim e aseteteve te reja te cilat nuk kane nevoje per shpenzime te larta mirembajtje. Ndersa per vitet 2013 dhe 2014 perderisa kompania ne aplikimin e saj nuk ka paraqitur llogaritje grupi i punes propozon qe ashtu si edhe kompanive te tjera te indeksohen per normen e inflacionit.

Zeri blerje energji per humbjet

Niveli i humbjeve te energjise elektrike ne sistemin e transmetimit ka ardhur duke u ulur si vlere ne perqindje te energjise se transmetuar per shkak te venies ne pune te projekteve te reja te cilat kane pasur nje ndikim te rendesishem edhe ne reduktimin e humbjeve te energjise elektrike ne transmetim. OST ka parashikuar nivelin 3% te humbjeve per vitin 2012.

Korrigjimi me 23 milion leke per sasine e energjise per mbulimin e humbjeve ne sistemin e transmetimit vjen si pasoje e korigjimit te cmimit te prodhimit si edhe e axhustimit te sasise se energjise se levruar ne sistemin e transmetimit.

Ndersa per vitet 2013 dhe 2014 ky ze eshte parashikuar respektivisht ne vleren 218 milion leke dhe 233 milion leke.

Zeri "Shpenzimet qe lidhen me personelin"

Paraqitet me nje rritje prej rreth 15% krahasuar me vitin 2011. Shtesa prej 128 milion leke argumentohet nga OST me shtesen prej 49 punonjesish. Kjo shtese vjen si rezultat i venies ne pune te N/stacionit te ri 400 kV Tirana 2 (18 punonjes), dispecerat rajonal ne N/stacionet Koman dhe Vau i Dejes (26 punonjes) dhe brigade e linjave Sarande (5 punonjes)si dhe me zbatimin e struktures se re organizative te kompanise. Gjithashtu eshte parashikuar rritje e pagave per kompensimin e rritjes se inflacionit. Ndersa per vitet 2013 dhe 2014 perderisa nuk kemi nje aplikim te kompanise propozojme qe ashtu si edhe kompanive te tjera te indeksohen per normen e inflacionit.

Tabela me poshte paraqet "Numrin mesatar te punonjesve dhe pagen mesatare per vitet 2008-2012 (Milion Leke)"

2008		2009		2010		2011		2012	
Nr puno njes	Paga Mesatare	Nr puno njes	Paga Mesatare	Nr puno njes	Paga Mesatare	Nr puno njes	Paga Mesatare	Nr puno njes	Paga Mesatare
643	44,381	664	44.584	691	49.146	723	50.178	751	54.857

	Miratuar nga ERE	Realizuar
Shpenzime personeli per vitin 2010	714,000	696,906
Shpenzime personeli per vitin 2011	858,000	830,000

Zeri "Pagesa per zhdemptim shtepie"

Ky ze i paraqitur ne aplikimin nga kompania eshte parashikuar ne vleren 287 milion leke dhe perfshin shpronositet e pronareve, qe preken nga ndertimi i linjes 400 kV Tirane-Elbasan, ndertimi i linjes 400 kV Tirane-Podgorice, ndertimi i Nenstacionit Elektrik 400/220/110 kV Kashar, dhe ndertimi i Qendres Dispeçer Kashar, sipas VKM-ve perkatese. Grupi i punes propozon qe ky ze duhet te jete pjese e investimeve te vitit 2011 per kete arsye eshte shtuar ne zerin e investimeve te realizuara per vitin 2011.

Elementet e CAPEX - it

Amortizimi

Amortizimi - eshte llogaritur nga OST sh.a duke perdorur normat fiskale, sic dhe parashikohet ne metodologjine e llogaritjes se tarifes se trasmetimit te energjise elektrike. Ky shpenzim eshte llogaritur nga OST ne vleren 985 milion leke per vitin 2012 dhe eshte parashikuar nga ERE me vleren 902 milion leke dhe 872 milion leke respektivisht per vitet 2013 dhe 2014.

Duke marre ne konsiderate shtimin e aseteve te reja qe jane kapitalizuar per vitin 2011 dhe atyre qe priten te kapitalizohen per vitet 2012-2014 respektivisht me

vlerat 10620, 9000, 3600, 6480 milion leke gjykojme qe ky shpenzim i kerkuar nga kompania eshte i arsyeshem.

Kthimi mbi bazen e rregulluar te aseteve

Ne llogaritjen e Bazes se Rregulluar te Aseteve (RAB) per shumen 25,108 milion leke per vitin 2012, 30254 milion leke per vitin 2013 dhe 34453 milion leke per vitin 2013 jane perfshire:

Asetet e Reja

- asetet e reja ne shumen 9,000 milion leke per vitin 2012
- asetet e reja ne shumen 3,600 milion leke per vitin 2013
- asetet e reja ne shumen 6,480 milion leke per vitin 2014

Amortizimi i akumuluar

- Amortizimi i akumuluar deri ne 31.12.2011 per shumen 4,797 milion leke
- Amortizimi i akumuluar deri ne 31.12.2012 per shumen 5,782 milion leke
- Amortizimi i akumuluar deri ne 31.12.2013 per shumen 6,684 milion leke
- Amortizimi i pritshem per vitin 2012 per shumen 985 milion leke
- Amortizimi i pritshem per vitin 2013 per shumen 902 milion leke
- Amortizimi i pritshem per vitin 2014 per shumen 872 milion leke

Kosto e kapitalit (WACC)

- Kosto e kapitalit (WACC) pas taksave eshte marre 5.47% per vitin 2012 dhe ne vlere absolute 1374 milion leke. Ne mungese te te dhenave nga kompania per vitin 2013 dhe 2014 mendojme te perdorim te njejten norme kthimi 5.47% per vitin 2013 dhe 5.47% per vitin 2014 dhe ne vlere absolute 1,656 milion leke leke per vitin 2013 dhe 1886 milion leke per vitin 2014.

Kapitali i punes

Kapitali i punes per shumen 159 milion leke per vitin 2012, 163 milion leke per vitin 2013 dhe 170 milion leke per vitin 2014.

Nga sa me siper rezulton se, te ardhurat e kerkuara mesatare (OPEX dhe CAPEX) per OST sh.a. per periudhen 2012-2014 propozohen te jene 4,021 milion leke qe i korespondojne nje tarife mesatare prej 0.65 leke /kWh

2.8 TARIFA E SHERBIMIT TE SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE PER OSSH SH.A. PER PER PERIUDHEN RREGULLATORE 2012-2014.

Ne daten 01.09.2011 CEZ Shperndarje sh.a. , paraqiti prane ERE-s aplikimin per tarifen e sherbimit te shperndarjes per periudhen e trete rregullatore 2012-2014. Kerkesat per te ardhura per cdo vit te periudhes rregullatore ku bazohen edhe propozimet e kesaj shoqerie per tarifat e reja jepen ne tabelen ne vijim:

TE ARDHURAT		2012	2013	2014
Operatori I Sistemit te Shperndarjes				
Kerkesa per te ardhura ne shperndarje	mil. ALL	28,561.528	28,263.375	27,224.685
Kosto e humbjeve	mil. ALL	14,427.335	13,410.757	11,672.822
Shpenzimet operative	mil. ALL	8,120.129	8,420.573	8,732.135
Amortizimi	mil. ALL	4,196.125	4,196.125	4,175.159
Norma e kthimit	mil. ALL	2,293.810	2,395.572	2,342.258
Baza e Aktiveve te Rregulluara	mil. ALL	23,596.439	23,536.761	23,417.897
<i>Aktivet afatgjata</i>	mil. ALL	21,717.484	21,717.484	21,717.484
<i>Kapitali I Punes</i>	mil. ALL	1,878.955	1,819.278	1,700.413
<i>Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit</i>	%	9.721%	10.178%	10.002%
Kompesimi I shperndarjes	mil. ALL	324.130	640.348	1,102.311
Lidhjet e reja dhe te ardhurat shtese	mil. ALL	-500.000	-500.000	-500.000
Te ardhura nga energjia reaktive	mil. ALL	-300.000	-300.000	-300.000

Vlen te sqarohet se kerkesa e mesiperme i perket aplikimit fillestar mbi te cilen u mbeshtet shqyrtimi dhe analiza e shifrave nga grupi i punes se tarifave, pasi kjo kerkesa me pas ndryshoi si pasoje e ndryshimeve te pritshme ne ligjin per sektorin e energjise elektrike .

Konkretisht amendimi i ligjit te energjise elektrike lidhur me liberalizimin e tregut te energjise per perdoruesit e lidhur ne rrjetin e TL dhe ata me konsum vjetor me te larte se 50 milion kWh ne te gjitha nivelet e tensionit con ne reduktimin e kerkeses per energji te klienteve tarifore te parashikuar fillimisht nga ana e shoqerise se shperndarjes.

Kerkesa e ndryshuar jepet ne tabelen qe vijon:

Zerat e Bilancit	Balanci energjise i v.2012 sipas aplikimit fillestar				Balanci energjise i v.2012 i ndryshuar			
	Shperndarja		Furnizimi		Shperndarja		Furnizimi	
	Nr. Konsumator eve	En. Shperndare (MWh)	Nr. Konsumator eve	En. Shperndare (MWh)	Nr. Konsumator eve	En. Shperndare (MWh)	Nr. Konsumator eve	En. Shperndare (MWh)
En.totale	1,035,624	4,667,677	1,192,409	5,418,724	1,186,811	4,594,662	1,186,815	4,594,662
Norma e lejuar e humbjeve		25.92%				25.92%		
Sasia e humbjeve		1,633,183				1,607,636		
En.totale e levruar/blere		6,300,860		5,418,724		6,202,298		4,594,662
110kV- te lidhur ne TSO			3	625,453	0	0		
Nentotale								
TN -220kV					0	0	3	0
TN -110kV	2	73,015	3	193,015	2	0	3	0
TM - 35kV	78	47,536	78	47,536	78	47,536	78	47,536
TM - 20/10/6 kV	6,269	88 9,481	6,269	889,481	6,269	889,481	6,269	889,481
TU tregetia	6,269	89 9,899	157,456	899,899	157,456	899,899	157,456	899,899
TU Familjare	1,023,006	2,757,746	1,023,006	2,757,746	1,023,006	2,757,746	1,023,006	2,757,746
deri 300 kWh	820,780	1,927,720	820,780	1,927,720	820,780	1,927,720	820,780	1,927,720
mbi 300 kWh	202,226	777,328	202,226	777,328	202,226	777,328	202,226	777,328
Ambjente te perbashketa	0	52,698	0	52,698	0	52,698	0	52,698
Konsumi i brendshem (i papershire ne bilanc)	285	5,594	285	5,594	285	5,594	285	5,594

Krahas bilancit te ndryshuar te energjise, CEZ Shperndarje paraqiti edhe rillogaritjet perkatese per tarifat e shperndarjes te klienteve tarifore ne te cilat u mbeshtet edhe analiza e metejshe e grupit te punes.

Pervec reflektimit te ndryshimeve te shifrave te lidhura drejtperdrejt me bilancin e energjise, rillogaritjet ne aplikimin per tarifa te CEZ Shperndarje permbanin edhe disa ndryshime te tjera konkretisht:

- Reduktimin e OPEX-it te Shperndarjes per 817 milion leke, vlere kjo qe lidhet me shpenzimet e parashikuara per testimin dhe certifikimin e matesave nga subjekti i autorizuar (labororet). Kjo ulje vjen si rezultat i ndryshimit te kushteve (parametrave) te meposhtem:
 - Inspektimi jo periodik i bazuar ne ankesat paguhet nga konsumatorët
 - Verifikimi fillestar behet ne kampione ne masen 5% te matesave elektrike te shperndare.
 - Verifikimi periodik behet per 67,000 matesave elektrike ne vit.
- Kompensimi i Borxhit te Keq vendoset ne nivelin e 16.85% sipas skenarit te mundshem te llogaritjes ne Studimin e Borxhit te Keq duke perfshire metodologjine e llogaritjes – me variantin e marreveshjes me shtetin Shqiptar, qe parashikon mosperfishirjen e borxheve te prapambetura te klienteve buxhetore dhe jobuxhetore ne perlllogaritjen e borxhit te keq.

Me ndryshimet e inpleteve si me sipër, të ardhurat e kërkuara për aktivitetin e shpërndarjes për periudhën e trete rregullatore 2012-2014 janë perkatesisht 27 185 milion leke, 27 004 milion leke dhe 26 779 milion leke:

Mbas një shqyrtimi të kujdesshem të të gjithë elementeve përberës të kërkesës së shoqërisë CEZ Shpërndarje, përfshirë këtu edhe sqarimet e marra nëpërmjet informacionit plotësues sidhe atyre të bëra në seancat teknike, grupi i punës propozon si më poshtë:

Tabela e të ardhurave të kërkuara për aktivitetin e shpërndarjes për vitin 2011 dhe periudhën rregullatore 2012-2014.

Zeri			Propozimi ERE			Aplikuar nga CEZ Shperndarje		
	2011	2011.1	2012	2013	2014	2012	2013	2014
Kosto personeli	3,678	3,678	2,834	2,948	3,066	3,234	3,353	3,478
Post-telekomunikacion	97	97	138	143	149	138	143	148
Materiale	1,170	1,170	1,076	1,119	1,164	1,076	1,116	1,157
Riparime dhe mirembajtje	129	129	53	55	57	53	55	57
Trajnime , dieta	59	59	45	47	49	45	47	48
Konsulenca dhe auditime	1,104	1,104	50	60	62	245	254	263
Kosto sigurie	117	117	231	240	250	231	240	249
Shpenzime Rregullimi/penalitetet	18	18	65	68	70	65	67	70
sherbime korporate			240	250	260	1,274	1,321	1,370
Qera	212	212	212	220	229	212	220	228
Kosto te tjera	113	113	611	530	552	730	758	787
	0	-	(273)					
Total	6,697	6,697	5,283	5,680	5,908	7303	7574	7855
kosto tso per humbje	0	931	792	744	585			
Kosto e Humbjeve	11,667	10,960	11352	9341	7953	14,202	13,208	11,502
	0							
Total OPEX	18,364	18,587	17,426	15,765	14,446			
Vlera e aseteteve sipas bilancit te v.2007	16,329	16,329	16,329	16,329	16,329	16,329	16,329	16,329
Vlera e investimeve te kryera ne vitin 2008	1,954	1,954	1,954	1,954	1,954	1,954	1,954	1,954
Asete te financuara npr Granteve	-770	-770	-770	-770	-770	-770	-770	-770
Asete te ndertuara nga KESH dhe te transferuara ne OSSH	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100
Vlera e investimeve te kryera per Janar-Maj 2009	3,287	3,287	3,287	3,287	3,287	3,287	3,287	3,287
Vlera e investimeve te kryera per Qershor-Dhjetor 2009	618	618	618	618	618	618	618	618
Vlera e investimeve qe pritet te realizohen ne v.2010	4,540	4,680	4,681	4,681	4,681	4,682	4,682	4,682
Vlera e investimeve te miratuara per vitin 2011	4,896	2,395	2395	2395	2395	2,396	2,396	2,396
minus: Vlera e mesvitet te investimeve te reja te 2011	-2,448	-1197.5	3250	6500	6500	6,500	6,500	6,500
				3346	6692		6,693	6,693
					3501.5		7,003	7,003
						-13,676	-17,660	-22,088
minus : Amortizimi i akumuluar	-8,287	-10,138	-13673	-17656	-22084	19,169	21,782	24,201
Vlera e RAB per v.2011 pa perfshire Kapitalin e Punes	19,294	18,257	19,170	21,783	24,203	21,717		
Kapitali i Punes	1,530	1,549	1,452	1,314	1,204	1,787	1,726	1,607
RAB 2011	20,824	19,806	22,631	22,493	22,383	23,504	23,443	23,324
Norma e interesit te borxhit te vjeter	1.784%	1.784%	1.758%	1.54%	1.409%	1.758%	1.540%	1.405%
Norma e interesit te borxhit te ri	10.254%	4.390%	9.107%	10.865%	9.087%	9.107%	10.865%	9.087%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	16.44%	16.44%	16.44%	16.44%	16.44%	16,440%	16,440%	16,440%
Borxh i Vjeter- %	32.50%	32.50%	31.56%	31.28%	26.39%	31.56%	31.28%	26.39%
Borxh i Ri - %	27.50%	27.50%	28.44%	28.72%	33.61%	28.44%	28.72%	33.61%
Raporti i Synuar i Kapitalit te Vet	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%
Kthim per borxhin e vjeter	0.58%	0.58%	0.55%	0.48%	0.37%	0.55%	0.48%	0.37%
Kthim per borxhin e ri	2.82%	1.21%	2.59%	3.12%	3.05%	2.59%	3.12%	3.05%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%
WACC	9.98%	8.37%	9.721%	10.178%	10.002%	9.721%	10.178%	10.002%
Fitimi	2,077	1,657	2,200	2,289	2,239	2,285	2,386	2,333
Amortizimi i Vitit	3,126	3050	3,966	3,966	3,966	4,196	4,196	4,175
Te ardhura nga Lidhjet e Reja	-580	(580)	-500	-500	-500	-500	-500	-500
te ardhurat nga Energjia Reaktive	-235	(235)	-300	-300	-300	-300	-300	-300
Kompensimi i humbjeve dhe amortizimi 2009&2010	3,207	2,421				0	441	1,714
Axhustimi i cmimit te energjise se blere per humbjet per viti	-1,086							
Kompensimi i humbjeve dhe amortizimi sipas DR	301							
Totali i te Ardhurave te Kerkuara	25,174	24,901	22,792	21,221	19,851	27,120	26,936	26,707
Energji e levruar ne rrjetin e shperndarjes	3,995	4004.43	4111	4275	4446	4,595	4,756	4,922
Tarifa mesatare e shperndarjes	6.30	6.218	5.5	5.0	4.5	6	6	5

Vleresimi i kerkeses per te ardhura te shoqerise CEZ-Shperndarje per cdo vit te periudhes se trete rregullatore 2012-2014.

Shpenzimet Operative (OPEX)

Ne tabelen qe vijon paraqitet kerkesa e shoqerise per Shpenzimet Operative te operatorit te sistemit te shperndajes dhe evoluimit te saj ne vite.

Ne milion leke

OPEX Shperndarje	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kosto te Personelit	2,642	3,296	3,630	3,678	3,234	3,353	3,478
Pagat qe lidhen me matjen		238	262			0	0
Posta & telekomunikacioni		81	83	97	138	143	148
Materiale	1,890	1,244	2,044	1,170	1,076	1,116	1,157
Riparim dhe mirembajtje				129	53	55	57
Udhetime dhe trajnime		88	91	59	45	47	48
Konsulence dhe auditim				1,104	245	254	263
Sherbime te korporates					1,274	1,321	1,370
Kosto te sigurise				117	231	240	248
Penalite dhe gjoba(Shpenz.Rreg)	652	49	54	18	65	67	70
Qera		1,154	1,683	212	212	220	228
Kosto te tjera	28	229	366	113	1547	1,604	1,664
Furnitura dhe sherbime	437						
Total OPEX	5,649	6,379	8,213	6,697	8,120	8,420	8,732
Zbriten nga zeri "Kosto te tjera"					817	846	877
Total OPEX sipas kerkeses se rillogaritur					7,303	7,574	7,855

Sikurse verehet nga tabela e mesiperme, Shpenzimet Operative(OPEX) te kerkuara per vitin 2012, pa perfshire blerjen e energjise elektrike per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes, paraqiten me rritje prej 9% krahasuar me ate te miratuar per vitin 2011. Kjo rritje e kerkeses per te ardhura te zerave te OPEX-it vjen si rezultat i indeksimit te te gjitha zerave te shpenzimeve me treguesin e indeksit te kombinuar dhe parashikimit te shpenzimeve per verifikimin e matesave i cili do te kryhet nga nje subjekt i pavarur ne perputhje me nenin 51 te Ligjit per Sektorin e energjise te inkluduara ne zerin "shpenzime te tjera".

Nga sa paraqitet ne tabelen me te dhenat e OPEX-it verehen ndryshime nga viti ne vit ne strukturen e zerave te ketij grupi shpenzimesh si dhe ne vleren e tyre qe vjen si rezultat i ndryshimeve ne organizimin e kompanise.

Grupi i punes i analizoi me kujdes te gjitha zerat e shpenzimeve dhe ecurine e tyre pergjate periudhave te rregullimit duke i krahasuar vlerat e njohura ne tarife me te dhenat e pasqyrave financiare. Gjithashtu, verifikimit te shpenzimeve operative i ka sherbyer edhe monitorimi i kryer nga ana e ERE-s prane kompanise me objekt kontrollin e ketyre kostove faktike per vitin 2011 si vit testimi sic parashikon edhe metodologjia e llogaritjes se tarifes se shperndarjes.

Ne lidhje me kerkesen per te ardhura per mbulimin e OPEX-it shpjegojme sa me poshte:

Shpenzimet per paga:

Eshte zeri me peshen me te madhe ne kete grup prej mesatarisht 48 % te totalit.

Ne tabelen me poshte jepet nje detajim i numrit te punonjeseve dhe te pages mesatare per vitet 2009-2012 (Ne menyre te permbledhur per kompanine).

Te dhena lidhur me pagat e punes per periudhen 2009-2012

CEZ_Sherndarje	Njesia	2009		2010		2011		2012		
		Miratuar ne tarife	Shpenzimet faktike (Bilanc 2009)	Miratuar ne tarife	Shpenzimet faktike (Bilanc 2010)	Miratuar ne tarife	I pritshmi (deklaruar nga kompania)	I pritshmi sipas monitorimit te ERE-s	Kerkesa e kompanise	Propozimi i grupit te punes
Nr. Mesatar i punonjesve	numer		6,013	5,798	5,031	4,973	4,867		4,514	
Kosto totale e personelit	Mil. leke	3,980	3,764	4,383	3,470	4,204	3,729	3,200	3,819	3,419

Duhet theksuar se llogaritjet ne paga kane perfshire indeksimin per inflacionin dhe nje norme rritje vjetore qe se bashku japin nje rritje te pages mesatare prej afersisht 10%.

Nisur nga te dhenat e shpenzimeve faktike te kryera nga kompania per fondin e pagave te punonjesve gjate viteve 2009/2010/2011 rezultojne diferenca te ndjeshme kundrejt kostove te njohura ne tarifa per kete ze. Nderkohe Grupi i Punes gjykon se cdo bonus qe shoqeria kerkon t'u akordoi punonjesve per permiresimin e performances se shoqerise (konkretisht uljen e humbjeve dhe rritjen e arketimeve) duhet te perfshihet ne te ardhurat shtese qe shoqeria mund te realizoje si pasoje e politikave incentivuese qe ERE ka aplikuar per shoqerine. Ulja e humbjeve dhe rritja e arketimeve do te justifikonte cdo bonus qe shoqeria planifikon t'u jape punonjesve te saj. Per me teper, qe nga ana e shoqerise nuk eshte paraqitur ne aplikim dhe ne sqarimet dhe informacionet shtese te dhena me pas, asnje detajim konkret per menyren sesi funksionon dhenia dhe shperndarja e bonuseve per punonjesit, perfshire ndonje liste-pagese konkrete apo kontratat e punes qe mund te kishin parashikuar dhenien e bonuseve te tilla.

Per sa me siper, nisur nga konstatimi i grupit te monitorimit te ERE-s mbi mosrealizimin e ndjeshem te zerit te shpenzimeve per paga te personelit te njohura ne te ardhurat e kerkuar per periudhat e mepareshme rregullatore, kerkesa per te ardhurat e vitit 2012 ne zerin "shpenzime te personelit" te reduktohet per shumen 400 milion leke.

Shpenzimet per zerin "Posta dhe telekomunikacioni" kerkohen ne vleren 138 milion leke kundrejt 97 milion leke te njohura per vitin 2011. Kjo rritje eshte rezultat i rishperndarjes se ketij shpenzimi ndermjet dy aktivitetve, pasi ne aktivitetin e shitjes ky ze eshte planifikuar me ulje ndaj vitit 2011. Mendojme qe te ardhurat e kerkuara per mbulimin e ketyre kostove te mbeten ne nivelin e kerkuar nga kompania, nisur kjo edhe nga argumentimi qe ky shpenzim ndikon ne uljen e debitoreve.

Shpenzimet per materiale dhe mirembajtjen propozohet te pranohen sipas parashikimeve te CEZ Shperndarje. per arsye se mirembajtja e rrjetit eshte e domosdoshme per rritjen e gadishmerise se furnizimit me energji elektrike. Nisur nga ecuria ne vite e ketyre shpenzimeve, por sidomos gjate viteve 2010-2011;(perkatesisht 2,044 milion leke,dhe 1299 milion leke) vihet re se ato kane ardhur ne ulje. Prandaj konsiderohet e arsyeshme propozimi i paraqitur ne zerin shpenzime materiale dhe riparime e mirembajtje prej 1,129 milion leke (Shperndarja) dhe 115 milion leke Shitja)

Shpenzimet per qirate perfshijne shpenzimet per :

- Qirate e magazinave ne perputhje me konceptin e ri te llogjistikes, ate te centralizimit te magazinave.
- Qirate e automjeteve te kompanise, per realizimin e aktivitetit te identifikimit te humbjeve joteknike si dhe te aktivitetit te arketimeve, ne vend te perdorimit te CAPEX-it te kufizuar. Nisur edhe nga studimi mbi analizen kosto-perfitim ne lidhje me praktiken e kesaj qeramarrje paraqitur nga CEZ Shperndarje gjate shqyrtimit te tarifave per vitin 2011, mendojme qe ky shpenzim eshte i arsyeshem. Si rezultat i kerkesave dhe standarteve me te larta ne drejtim te permiresimit te kushteve te kryerjes se aktiviteteve nga ana e kompanise, shuma prej 212 milion leke te kerkuar per kete qellim, konsiderohet e arsyeshme.

"Sherbime te Koorporates" jane parashikuar nga kompania ne vleren 1,274 milion leke per vitin 2012, i cili paraqitet si ze i vecante OPEX-it ne aplikimin e kompanise. Nga shpjegimet qe kemi marre nga kompania ky grup shpenzimesh

perfshin shërbimet e përbashkëta, të cilat me parë kanë qenë të shpërndarë në zërat e tjere të OPEX-it sipas natyrës së tyre.

Për verifikimin dhe njohjen e natyrës dhe vlerave reale të këtyre kostove nga ana e ERE-s u realizua një monitorim gjatë muajit Nëntor 2011, gjatë të cilit u konstatua se janë bërë pagesat për këto shërbime për vitet 2010 e 2011 me fatura të rregullta TVSH-je për shërbime periodike të parashikuara në kontratat përkatëse. Nga natyra e tyre këto shpenzime përfshijnë:

- Prokurime dhe Logjistika, Shërbimet financiare, kontrolli, kontabiliteti, menaxhimi i burimeve njerzore, Prokurimet dhe Menaxhimi i materialeve, ndihma operacionale dhe rregullatore, aktiviteti i thesarit, marrëdhëniet me publikun, etj

Pavaresisht argumentimit nga ana e CEZ Shpërndarje për dobine dhe përfitimet e kompanisë prej këtyre shërbimeve, grupi i punës bazuar edhe në të dhënat e monitorimit në lidhje me pagesat e kryera nga kompania gjatë viteve 2010 dhe 2011 konstatoi se kompania ka kryer pagesa me fatura të rregullta TVSH-je, por ato nuk ishin të shoqëruar me dokumenta justifikues apo argumentime, gjë që nuk lejonte të gjykojë nëse këto kosto ishin të arsyeshme. Për më tepër, kompanisë i është kërkuar analiza kosto/përfitim me të dhëna të detajuara për çdo shërbim lidhur me këto kosto, por nga dokumentat e dërguara nga ana e shoqërisë perseri mbetet raportimi i vlerave në total.

Për këtë arsye u gjykua që të mos pranohet një shumë të tillë shpenzimi si i arsyeshëm dhe i justifikuar, kërkuar nga kompania, vetëm mbi bazën e një kërkesë përshkruese dhe jo mbi bazën e llogaritjeve analitike.

Se fundmi grupi i punës propozon që të reduktojë kërkesën e kompanisë për shumën 1,000 milion leke me arsyetimin se mungon analiza bindëse dhe për më tepër nevojë për "shërbimet nga të tretë" nuk është e njëjta si në vitet e para të operimit të kompanisë (ristrukturimit të saj) e cila tashmë konsiderohet një fazë e kapërcyer.

Shpenzimet për konsulencë dhe auditime përfshijnë shpenzimet në lidhje me trajnimin e personelit e stafit në terren, materiale, shërbime të konsulencave ligjore, si dhe pagesa në lidhje me auditimet që priten të kryhen për vitin 2012. Krahasuar me vitin 2011 ky zë i OPEX-it paraqitet me ulje të ndjeshme nga 1,104 milion në 245 milion leke.

Pavaresisht kësaj ulje grupi i punës propozon që kjo shifër të reduktohet me 195 milion leke, pasi vlera prej 245 milion leke nuk është e argumentuar.

Nisur nga të dhënat e marra nga kompania gjatë monitorimit të OPEX-it të vitit 2011 rezultoi se në këtë zë përfshiheshin shumën e auditimeve dhe konsulencave që tashmë janë të kryera (si ato nga PWC për studimin e humbjeve, Deloitte për studimin e borxhit të keq, AT KEARNEY për ristrukturimin e shoqërisë). Perseri,

permendim faktin se kompania edhe pas kerkesave te vazhdueshme dhe ne ditet e fundit, nuk paraqiti nje detajim me analitik te parashikimit te ketij shpenzimi.

Nga ana e shoqerise nuk jepet e paqarte domosdoshmeria e kryerjes se ketyre shpenzimeve ne vleren e kerkuar, per periudhen e ardheshme rregullatore per kete arsye, propozojme qe shuma prej 50 milion eshte e arsyeshme per realizimin e ketij sherbim per vitin 2012 dhe me tej ky shpenzim per vitet pasardhese do te indeksohet ashtu si dhe shpenzimet e tjera te OPEX-it .

“Kosto per sigurine”: sherbejne per mbulimin e kostove per sigurine e objekteve te tilla si nenstacione, magazinat si dhe te gjitha objektet qe i sherbejne aktivitetit te shperndarjes. Shuma prej 231 milion leke e kerkuar per vitin 2012 eshte parashikuar me rritje prej 97% ndaj asaj te vitit 2011, por ne total per te dy aktivitetet (shperndarje e furnizim) kostot e sigurise paraqiten me nje ulje prej 93 milion leke. Ky ze i koston propozohet te mbetet ne nivelin e kerkuar nga kompania per vete rendesine qe ai ka per kryerjen e aktivitetit ne kushte normale.

“Kosto te tjera”: Fillimisht kerkesa per kete ze shpenzimesh ishte 1,546 milion leke dhe me pas sic jemi shprehur edhe me siper mbas reduktimit te shumes prej 817 milion lekesh te aktivitetit te pavarur te verifikimit te matjes shkon ne 729 milion leke, nga te cilat 305 milion i perkasin aktivitetit te matjes dhe diferenca prej 424 milion leke perfaqeson kosto te tjera qe kane te bejne me sigurimin e pasurise, pagesa uji, reklame & publicitet etj. Gjithashtu ne kete shifer eshte perfshire edhe vlera e projektit te ri qe parashikohet te implementohet per vitin 2012 ate te regjistrimit te asetave te shperndarjes prej 105 milion leke.

Gjykojme si te justifikuar per periudhen 2012-2014:

- perfshirjen e kostove per trealizimin e verifikimit te matesave sipas planit te parashikuar dhe propozuar nga kompania per shumen 306 milion leke
- 200 milion leke qe parfaqesojne kostot per pagesat e siguracioneve , noterizime, si dhe taksat lokale te parqituara ne aplikim
- Koston e projektit per regjistrimin e asetave prej 105 milion leke.

Per projektet e tjera te paraqitura ne aplikim gjykojme se pavaresisht pershkrimin te nevojës per realizimin e tyre, perseri nuk eshte i mjaftueshem per te justifikuar njohjen e shumes se kerkuar ne OPEX-in e shperndarjes , per arsye te mungeses se projektit dhe llogaritjeve perkatese per te konkretizuar analizen kosto-perfitim. Per me teper keto shuma kerkohen te indeksuara edhe per vitet pasardhese. Keshtu ne mungese te parashikimit dhe argumentimit per projekte te tjera u gjykua qe keto shuma te mos konsiderohen te arsyeshme per vitet 2013-2014.

Ky ze per periudhen 2012-2014 paraqitet respektivisht ne vlerat 611 milion leke, 530 milion leke dhe 552 milion, pra me nje ulje prej 26% per te gjithë periudhen.

“Shpenzimet per mbulimin e humbjeve” sipas kerkeses se ndryshuar te CEZ per vitin 2012 jane paraqitur per shumen 14,201 milion leke duke perfshire edhe koston per transmetimin energjise per humbjet me tarife 0,6 leke/kWh.

Kerkesa e kompanise per te ardhura per prokurimin e energjise elektrike per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes per vitin 2012 bazohet ne:

- Nivelin e humbjeve prej 25.92% ose 1,607 GWh
- Cmimi i importit te energjise elektrike prej 58.5 EUR/MWh
- Norma e parashikuar e kembimit leke/EUR = 140,75 Eur/Lek
- Tarifen e transmetimit 0.6 leke kWh

Niveli i humbjeve prej 25,92% me nje ulje prej 2% kundrejt nivelit te parashikuar per vitin 2011 nuk eshte ne perputhje me vendimin e Bordit te Komisionereve nr.93, date 30.11.2010 “Per miratimin e programit te uljes se humbjeve totale per tre periudhat e rregullimit” bazuar ne piken 4.5 te Deklarates Rregullatore *ku percaktohet niveli 16.92% deri ne fund te 2014*. Sipas ketij vendimi gjate periudhes se trete rregullatore objektivi i reduktimit te humbjeve eshte ne masen 11% kundrejt nivelit fillestar prej 27.92 % te vitit 2011.. Nderkohe CEZ Shperndarje propozon skedulim 2%, 2%, 3% perkatesisht per vitet 2012, 2013, 2014 qe do te thote 7% ulje gjithesej per periudhen.

Megjithë deklarimin e kompanise se ajo nuk mund te realizoje nje ulje me te madhe, grupi i punes propozon ne zbatim te vendimit te siperpermendur qe per efekt te llogaritjes se koston se energjise elektrike per mbulimin e humbjeve, skenari i reduktimit te humbjeve per periudhen 2012-2014 te jete :

Viti 2012	4 %
Viti 2013	4%
Viti 2014	3%

Keto objektiva jo vetem qe reflektojne objektivat e vendosura ne Deklaraten Rregullatore, por ne te njejten kohe si te mundeshme per tu arritur, duke patur parasysh se kompania pritet te realizoje nje plan te konsiderueshem investimesh gjate viteve te periudhes se trete rregullatore, te cilat duhet te jene te orjentuara kryesisht ne drejtim te permiresimit te humbjeve.

Sasia e energjise per mbulimin e humbjeve eshte llogaritur sipas formule si me poshte:

Sasia e livruar ne Shperndarje = Sasia e shitur ne shperndarje / (1 - perqindja e humbjeve)

$$(4,111 \text{ GWh} / (1 - 0,2392) = 5,403 \text{ GWh})$$

Sasia e energjise se humbur = Sasia e livruar ne shperndarje * Objektivi i humbjeve (%)

Bazuar ne tabelen e bilancit te energjise elektrike kjo sasi e energjise ne GWh per vitin 2012 eshte llogaritur si me poshte:

$$5,403 \text{ GWh} * 23.92\% = 1,293 \text{ GWh}$$

Parashikimi i cmimit te importit te energjise elektrike per mbulimin e humbjeve te energjise

Sic dihet ne nivelin e cmimeve te energjise elektrike te rajonit ndikojne faktore te ndryshem qe kane te bejne me zhvillimet ekonomike, nivelin e konsumit te energjise, cmimet e lendeve djegese per prodhimin e saj dhe situatat hidrologjike.

Llogaritja e shpenzimit per blerjen e energjise per humbjet ne rrjet eshte bere mbi bazen e sasise totale per tu importuar gjate vitit 2012 prej 1,293 GWh dhe cmimit te kontrates se blerjes nga CEZ Shperndarje te miratuar nga ERE prej 62.4 €/MWh me kurs kembimi 140.75 leke/€uro nga ku rezulton vlere prej 11,352 milion leke te ciles i shtohet edhe kosto e transmetimit te energjise prej 844 milion leke. Po keshtu eshte bere edhe rillogaritja e kostos se blerjes se sasise se energjise per humbje per vitet 2013 dhe 2014.

Shpenzimet Kapitale (CAPEX)

Amortizimi

Per percaktimin e vleres se amortizimit, qe do te perfshihet ne llogaritjen e tarifes se sherbimit te shperndarjes se energjise per vitin 2012 dhe per cdo vit ne vazhdim te periudhes se trete rregullatore (2013- 2014) mbahet parasysh fakti qe ky do te jete nje parameter fiks i mesatarizuar pergjate kesaj periudhe.

Metodologjia e llogaritjes se vleres se amortizimit per qellimin e percaktimit te tarifes se shperndarjes u trajtua gjeresisht ne relacionin e paraqitur per miratimin e

tarifes se vitit te kaluar 2011 dhe vlen edhe per llogaritjet e periudhes se trete te rregullimit te ciles i pergjigjet formula qe vijon.

Amortizimi i plote vjetor = amortizimi i Asetit te vjeter + amortizimi i Asetit te Ri
Nga zbatimi i kesaj formule rezultojne vlerat e amortizimit qe jepen ne tabelen e llogaritjes se te ardhurave te kerkuara.

Amortizimi i shtesave te aseteteve te reja eshte llogaritur ne perputhje me metodologjine e llogaritjes se tarifes se shperndarjes, pra me vleren nominale kumulative te mesit te periudhes se ciles i perkasin investimet e reja.

Ne aplikimin e saj fillestar, kompania ka kerkuar kompensim per amortizimin e aseteteve te vjetra (te blera para privatizimit) per vitet 2008, 2009, 2010 ne shumen 229 milion leke, gje qe nuk ishte e bazuar pasi ne tarifen e vitit 2011 u perfshi e vlera e plote e kompensimit te amortizimit te periudhave te meparshme. Per kete arsye nga ana e grupit te punes eshte bere korrigjimi ne zbritje i kesaj shume si me poshte:

Amortizimi		2012	2013	2014
Aplikimi CEZ	Mil.leke	4,196.125	4,196.125	4,175.159
zbritje	Mil.leke	229.371	229.371	229.371
Shuma sipas Grupit te punes	Mil.leke	3,966.754	3,966.754	3,945.788

Investimet per periudhen 2012-2014

Pas shqyrtimit te planit te investimeve te CEZ per periudhen 2012-2014, ERE vendosi te miratohet vlera e investimeve te parashikuara ne aplikimin e bere nga CEZ-Shperndarje, per cdo vit dhe te ndara sipas grupimeve .

Llogaritja e RAB dhe llogaritja e Koshtos Mesatare te Ponderuar te Kapitalit (WACC) per periudhen 2012 – 2014 mbeshtetet ne percaktimin e bere ne metodologjine e llogaritjes se tarifave te operatorit te shperndarjes dhe ne deklaraten rregullatore.

Ne tabelen e mesiperme te llogaritjes se te ardhurave te kerkuara per aktivietin e shperndarjes, jepen elementet perberes te formulave te llogaritjes se komponenteve te meposhtem.

Kapitali i Punes

Kapitali i Punes perfaqeson 1/12 e shpenzimeve operative per te gjithë periudhen e trete rregullatore respektivisht 1452 milion leke, 1314 milion leke dhe 1204 milion leke.

Kosto e kapitalit (WACC)

Llogaritja e koston mesatare te ponderuar te kapitalit(WACC) nga kompania eshte paraqitur sipas formule te miratuar ne Deklaraten Rregullatore.

Grupi i punes kerkoi informacion shtese nga CEZ Shperndarje lidhur me koston faktike te borxheve per t'i krahasuar ato me normat e njohura ne llogaritjet e RAB te viteve 2010, 2011.

Nga shqyrtimi i informacionit te paraqitur nga CEZ Shperndarje, lidhur me borxhet e reja per vitin 2011 kemi konstatuar se:

- Nga EBRD eshte marre kesti i pare i kredise gjate gjashtemujorit te dyte ne shumen prej 35 milion Euro per te cilin eshte paguar interes ne shumen 1.67 milion Eur (4.77%).
- Kredia per ndertimin e N/st te Kalimashit me vleften 506.5 milion leke eshte marre me norme interesi 0.75%.

Nisur nga sa me lart per vitin 2011 rezulton nje norme mesatare e ponderuar e interesit prej 4.39% nga 10.254% te pranuar nga ERE ne mbeshtetje te parashikimit te shoqerise ne aplikimin per tarifen e vitit 2011.

Duke marre per baze kete norme aktuale interesi, WACC-u i rillogaritur per 2011 rezulton te jete 8.37% nga 9.98% i miratuar nga ERE.

Ne aplikim jane paraqitur kushtet dhe koston shoqeruese te kredive te reja .

Ne perlllogaritjen e koston se borxhit jane pranuar per vitet 2012, 2013 dhe 2014 respektivisht kosto e borxhit te vjeter 1.758% , 1,504 % dhe 1,409 % dhe kosto e borxhit te ri 9,107% 10,865% dhe 9.087%.

Kthimi mbi RAB-eshte llogaritur konform metodologjive dhe rezulton per vitet 2012-2014 mesatarisht 2,243 milion leke, nga 2,335 milion leke i kerkuar.

Korrigjimet e periudhes aktuale 2011

Nga analiza e realizimit te te ardhurave te pritshme per periudhen aktuale 2011 propozohen korigjimet e meposhteme:

1. Ne llogaritjen e tarifes se shperndarjes, eshte bere korrigjimi ne rritje per shumen 223 milion leke per shkak te korrigjimit te sasise se energjise se blere per humbje si rezultat i ndryshimit te sasise se energjise te livruar ne rretin e sherperndarjes si pasoje e rritjes se energjise per shitje nga 3.995 GWh te miratuar ne tarifen e viti 2011 ne ate qe pritet te realizohet prej 4,004 GWh cmimit te energjise dhe kursit te kembimit te euros nga 138 leke /Euro ne 140.75 leke/Euro. Nga ana e kompanise ky korrigjim kap vleren 1,859 milion leke, shume e cila i perket nje parashikimi me te larte te shitjes se energjise tek klientet tarifore , se sa ai qe propozohet nga grupi i punes sic edhe eshte shpjeguar ne kapitullin “ Bilanci energjitik”te ketij relacioni.
2. Si pasoje e mosrealizimit te investimeve per vitin 2011, nga 4,896 milion leke te miratuar ne 2,395 milion leke, diferenca e perealizuar eshte objekt i korrigjimit ne zbritje. Kjo zbritje e RAB-it sjell nje reduktim te kthimit te pritshem nga 2,077 milion leke ne 1,657 milion leke. Efekti ne zbritjen e te ardhuarve te kerkuara eshte 420 milion leke .
3. Korrigjimi i amortizimit Ne lidhje me llogaritjen e shumes se amortizimit per vitin 2011 vihet re se megjithese investimet nuk jane realizuar ndjeshem , vlera e amortizimit eshte 1.6% me e larte se sa ajo e pranuar ne llogaritjen e tarifes se miratuar per vitin 2011, pra me nje rritje prej 50 milion lekesh. Nga kontrolli i tabelave llogaritime te paraqitura nga kompania ka rezultuar se kjo diferenca vjen sipasoje e ndryshimit te struktures se aseteteve te reja te kapitalizuara gjate viteve 2010-2011 kundrejt atyre te miratuara nga ERE, si dhe aplikimit te nje norme amortizimi prej 20%.(40% e aseteteve te reja per vitin 2010 dhe 20% e aseteteve te vitit 2011 jane makineri e paisje qe amortizohen me 20 %). Nisur nga ky fakt jane kerkuar nga ana jone listat analitike te ketyre paisjeve per te verifikuar nese realisht ato jane makineri me nje jetegjatesi 15 vjecare.

Megjithte kerkesen e vazhdueshme gjate takimeve te perbashketa, nga ana e kompanise nuk na u vu ne dispozicion nje informacion i tille.

Ne vijim sqarojme se referuar llogaritjeve te amortizimit te periudhes rregullatore 2011, e cila perfshin ne llogaritje shtesat e aseteteve te reja per vitin 2010 dhe atyre te vitit 2011, rezulton se amortizimi i planifikuar per vitin 2011 eshte afersisht 321 milion leke qe i pergjigjej nje plani investimesh prej 4,896 milion leke. Nderkohe realizimi i pritshem i deklaruar nga kompania eshte afersisht rreth 50% te atyre te planifikuara. Ne kete menyre e konsiderojme te arsyeshme se amortizimi i aseteteve

te reja per efekt te llogaritjes se tarifes se aktivitetit te shperndarjes te njihet ne te njejtin raport me realizimin e pritshem te investime, pra; $298/2=149$ milion leke. Per me teper kjo shume duhet te zbritet si e arsyeshme edhe per vete faktin se kompania pa marre miratimin e bordit te komisionereve ka ndryshuar strukturen e investimeve per vitin 2010 dhe 2011.

Ne vijim te ketij arsyetimi propozojme qe te korrigohet amortizimi i llogaritur nga kompania per vitin 2011 ne zbritje, per shumen 50 milion leke, shifer qe konsiderohet si diference ndaj atij te pritshem per vitin 2011 dhe atij te parashikuar ne tarifen e vitit 2011, deri ne saktesimin e te dhenave me mbylljen e vitit ushtrimor 2011, duke ju referuara per llogaritjeve analitike per cdo element te aseteteve fikse te vena ne operim. **Shuma prej 50 milion lekesh** si reduktim amortizimi eshte pasqyruar ne zbritje te amortizimit te akumulura per vitin 2011 (10,188milion leke -50 milion leke= 10,138 milion leke), sic tregohet ne tabelen e te ardhurave te kerkuar per aktivitetin e shperndarjes.

Se fundmi sqarojme se amortizimi i llogaritur per vitin 2011, gjithashtu, eshte reduktuar edhe per amortizimin e dhene me teper per vitin 2010 nga ai raportuar nga kompania per shumen **77 milion leke** (2621 milion leke -2545 milion leke).

Ne perfundim gjykohet se me perfundimin e vitit ushtrimor 2011 do te saktesohen vlerat dhe nese do te rezultojne te ndryshme do te axhustohen ne periudhen e mevoneshme.

Ne perfundim propozohet, qe te ardhurat e kerkuara te kompanise per aktivitetin e shperndarjes per vitet 2012-2014 te jene mesatarisht 21,888milion leke dhe tarifa mesatare e sherbimit te shperndarjes per periudhen e trete rregullatore te jete 5 leke /kWh nga 6.3 leke per kWh nga ajo qe ishte per vitin 2011.

2.9 TARIFA E SHERBIMIT TE FURNIZIMIT ME PAKICE (FPP) TE ENERGJISE ELEKTRIKE PER PERIUDHEN 2012-2014

Shpenzimet qe lidhen me veprimtarine e shitjes me pakice te propozuar ne aplikimin per tarifen e periudhes 2012-2014 nga ana e CEZ Shperndarje, ne funksionin e FPP, jane paraqitur ne tabelen ne vijim:

Furnizuesi Publik me Pakice		2012	2013	2014
Te ardhurat e kerkuara te FPP	mil. ALL	25,528.631	27,433.694	30,135.536
Kosto e blerjes se energjise (perfsh.marzhin)	mil. ALL	8,011.433	8,249.436	8,495.770
Kosto e TSO	mil. ALL	3,247.878	3,344.366	3,444.231
Shpenzimet Operative	mil. ALL	2,127.024	2,205.723	2,287.335
Marzhi I FPP	mil. ALL	176.252	181.488	186.907
Borxhi I Keq	mil. ALL	10,176.399	9,917.081	9,635.023
Kompensimi I FPP	mil. ALL	1,789.647	3,535.600	6,086.271

Te ardhurat e kerkuara si me siper i perkasin aplikimit fillestar, ndersa ne tabelen ne vijim paraqitet kerkesa per te ardhura te aktivitetit te shitjes me pakice sipas aplikimit me te fundit qe CEZ Shperndarje prezantoi nen efektin e ndryshimit te Ligjit per sektorin e energjise elektrike.

Kerkesa per te Ardhura te FPP		2012	2013	2014
		18 679,218	19 270,600	21 116,330
Kosto e blerjes se energjise nga FPP (perfshire marzhin e fitimit)	mil.ALL	6 800,100	7 038,104	7 284,437
Kosto e OST	mil.ALL	2 756,797	2 853,285	2 953,150
Shpenzimet Operative (OPEX)	mil.ALL	2 127,024	2 205,723	2 287,335
Marzhi i FPP	mil.ALL	149,602	154,838	160,258
Borxhi I Keq	mil.ALL	6 845,694	6 441,113	6 183,867
Kompensimi per FPP	mil.ALL	0	577,536	2 247,282

Ne vijin paraqesim tabelen " Kostot dhe te ardhurat e kerkuara per FPP (000 Leke)" per periudhen rregullatore 2012-2014.

Zeri	Propozuar ERE					Aplikuar nga Cez Shperndarje		
	2011	2011.1	2012	2013	2014	2012	2013	2014
Kosto Personeli	506		585	608	630	585	606	629
Post-Telekomunikacion	721		606	630	655	606	628	651
Materiale	0		108	112	117	108	112	117
Riparime dhe mirembajtje	0		7	7	8	7	7	7
Trajnime dhe Dieta	21		9	9	10	9	9	10
Konsulence dhe auditime	39		10	10	10	38	39	41
sherbime korporate			60	62	65	203	211	218
Kosto per sigurine	243		36	37	39	36	37	39
Penalitete, gjoba dhe deme	0		10	10	11	10	10	11
Qera	55		77	80	83	77	80	83
Te tjera	63		66	228	237	448	465	482
	0							
Alokimi i shpenzimeve te pergjithshme dhe adm	228							
Total	1,875	1,875	1,573	1,796	1,865	2,127	2,206	2,287
Total OPEX	1,875	1,875	1,573	1,796	1,865	2,127	2,206	2,287
Tarifa e blerjes se energjise nga FPSH Lek/KWH	1.48	1.48	2.84	2.51	3.14			
Blerjet e energjise nga FPSH- GWH	4,235	4,607	4,111	4,275	4,446			
Kosto totale e blerjes se energjise nga FPSH - Lek	6,279	6,831	11,693	10,726	13,942	6,800	7,038	7,284
Norma e fitimit te FPSH %	2.20%	2.20%	2.20%	2.20%	2.20%	2.20%	2.20%	2.20%
Fitimi	138	397	257	236	307	150	155	160
Kerkesa per te ardhura e OST	2,541	2,764	2,519	2,992	2,875	2,757	2,853	2,953
Kerkesa per te ardhura e OSSH	25,174	25,174	22,792	21,221	19,851	27,120	26,935	26,707
kompesim per Shpenzime te Borxhit te Keq te per	-		96				577	2,247
Axhustim kerkeses per energji			-3,545					
Shpenzime Borxhi te Keq	4,349	4,445	3,892	3,697	3,496	6,846	6,441	6,184
shpenzime per borxhin e keq per energjine reakti	-							
Te Ardhurat e Kerkuara Totale te FPP	40,356	41,486	39,278	40,668	42,335	45,800	46,205	47,822
Shitjet e energjise	4,235	4,607	4,111	4,275	4,446	4,595	4,757	4,920
Cmimi mesatar per konsumatorin tarifore	9.53	9.00	9.55	9.51	9.52	9.97	9.71	9.72

OPEX

Totali i OPEX-it ne vleren 2,127 milion leke te kerkuar per aktivitetin e FPP shenon nje rritje prej 13% krahasuar me vitin 2011. Ne tabelen qe vijon jepen te dhena per keto shpenzime per vitet 2009-2014.

OPEX FPP	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Paga	341	366	403	506	585	607	629
Dieta	9	10	10	21	9	9	10
Pagat qe lidhen me faturim+arketim	75	80	88			0	0
Material (+rip, mirmb 2012)					115	119	124
Konsulence				39	38	39	41
Informacione dhe reklama		29	30			0	0
Sherbime te korporates					203	211	218
Sherbime me qera	76	128	187	55	77	80	83
Sigurime-kosto te sigurise				243	36	37	39
Telefon & Sherbim postar	9	9	9	721	606	628	651
Shpenzime rregullimi	2	5	6		10	10	11
Te tjera (penalitete + komisione bankare, honorare, etj)	12	25	41	63	448	465	482
Alokimi i shpenzimeve te pergjitheshme				228			0
Totali OPEX	524	652	774	1,875	2,127	2,206	2,287

Nga analiza e ketyre shpenzimeve ne tabelen me siper terheq vemendjen zeri "Shpenzime te tjera" 448 milion leke si ze me nje rritje teper te ndjeshme krahasuar me vitet e kaluara. Kompania ne aplikimin e saj ka shpjeguar arsyet e perfshirjes ne OPEX te kostove te nje sere projektsh te reja qe do te implementohen gjate vitit 2012 e ne vazhdim e qe do t'i sherbejne permiresimit :

- te sistemit te faturimit – me vleren 14 milion leke
- kujdesit ndaj klientit me krijimin e nje kanali te vecante komunikimi "call centre" me nje vlere 126 milion leke
- implementimit te kanaleve te reja te pageses me nje vlere 38 milion leke
- dergeses se faturave te energjise me nje vleren prej 154 milion leke
- parashikimit te kerkeses per energji me nje vlere 21 milion leke
- regjistrimi i asetëve dhe arshivimi i dokumentacionit

Kompania ne faqet 36-44 te aplikimit ka paraqitur nevojën per realizimin e ketyre projekteve te cilet rrisin efektivitetin e sherbimit te shitjes me pakice. Lidhur me keto shpenzime shprehim opinionin se paraqitja thjesht e kerkeses e shoqeruar me shpjegime per natyren e shpenzimit nuk eshte e mjaftueshme per te argumentuar nevojën per keto sherbime, pasi ato nuk shoqerohen me preventiva apo llogaritje te detajuara te zerave te ketyre shpenzimeve . Per keto aresye nuk eshte e sigurt se keto shpenzime nuk dublojne ato qe realizojne aktualisht dhe mbulohe nga element e te tjere te OPEX-it si paga , materiale.etj

Persa i perket zerave te tjere te OPEX-it vihet re ndryshimi ne strukturen e tyre. Konkretisht zeri “**Alokimi i shpenzimeve te pergjithshme**” te paraqitur ne aplikimin e vitit 2012 eshte zevendesuar me zerin “**Sherbime te korporates**” qe vjen per shkak te ndryshimeve strukture te FPP. Edhe per kete ze kemi te njejtin gjykim ashtu si dhe per aktivitetin e shperndarjes, prandaj konsiderojme te aresyeshme shumen prej 60 milion leke per vitin 2012.

Zeri Paga paraqitet me nje rritje prej 15.6% krahasuar me vitin 2011. Shuma e alokuar per kete ze shpenzimesh ne aktivitetin e shitjes sipas aplikimit te kompanise prej 585 milion lekesh, vjen si pasoje e rialokimit te shpenzimeve per paga per shkak te riorganizimit qe kompania parashikon per vitin e ardhshem.

Meqe nuk u mundesuan liste pagesat konkrete per te dy aktivitet e shperndarje dhe furnizim me pakice, dhe per faktin qe u reduktuan te ardhurat e kerkuara te aktivitetit te shperndarjes ne zerin e pagave per 400 milion leke, ne e propozojme te paprekur kete te ze te te ardhurave te kerkuara, duke e lejuar shoqerine te beje nje rialokim te ketij shpenzimi per te dy aktivitetet.

Shpenzimet per telefon dhe sherbimin postar te cilat jane kerkuar me nje ulje prej 100 milion lekesh krahasuar me vitin 2011 propozojme te mbetet ne shumen e kerkuar nga kompania.

Zeri “**konsulenca dhe auditime**” nga 38 milion reduktohet ne 10 milion leke, pasi nga ana e kompanise nuk jane paraqitur detajime per te justifikuar se keto shpenzime priten te ndodhin realisht.

Niveli i Borxhit te keq.

CEZ, ne percaktimin e nivelit te Borxhit te keq, eshte bazuar ne rezultatet e Studimit te Borxhit te Keq per vitet 2008, 2009 e 2010 te kryer nga kompania eksperte financiare e pavarur Deloitte Albania sh.p.k. sipas te cilit borxhi i keq rezulton perkatesisht ne nivelet 18.39%, 20.71% dhe 23.27%. Nderkohe ne variantin e derguar me pas, i cili reflekton ndryshimet ne Ligjin per Sektorin e energjise, CEZ ka propozuar nivelin e borxhit te keq ne 16.85% per vitin 2009 sipas variantit te marreveshjes se mundshme me shtetin Shqiptar per shleyerjen e borxheve te ndersjellta.

Kerkesa e kompanise per borxhin e keq eshte ne mosperputhje me vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s me vendimin Nr. 99 Date 30.09.2011, i cili vendosi miratimin ne parim te Studimit te Borxhit te Keq me disa korrektime si rrezultat i te cilave nivelet aktuale te Borxhit te Keq per vitet 2008, 2009, 2010 u percaktuan respektivisht ne nivelet 14%,14% dhe 13 %.

Per sa me lart, niveli i borxhit te keq perlogaritjen e tarifes per vitet 2012-2014 nga ana jone eshte pranuar ne nivelet 11%, 10% e 9%

Korrigjimi i te ardhurave te FPP, si pasoje e ndryshimit te sasise se energjise elektrike per konsumatoret tarifore per vitin 2011 nga ai i parashikuar ne tarifen e miratuar per kete periudhe.

Llogaritjet e CEZ-it ne aplikim:

5133 GWh * 9.61(Cmimi mesatar i shitjes)	=49.328 milion leke
Te ardhurat e miratura per vitin 2011	= 40.356 milion leke
Diferenca per tu korigjuar	= 8.999 milion leke

Llogaritjet ERE ;

Te ardhurat aktuale 2011	=4607 GWh * 9.61 = 44.273 milion leke
Te ardhurat e miratuar	=40.356 milion leke
Diferenca	=3.917 milion leke

Per pasiguri te cmimit meastar te shitjes nga 9.53 leke/kwh ne 9.61 leke/kwh (meqe CEZ Shperndarje nuk paraqiti llogaritje te struktures se shitjes si pasoje e reduktimit te sasise se energjise se shitur per vitin 2011 sic u kerkua nga ERE) propozojme qe korrigjimi ne ulje i te ardhurave nga shitja e energjise te jete 3.545 milion leke. Me perfundimin e vitit ushtrimor 2011 te ardhurat aktuale mund te korigjohen me vleren korrekte.

Si konkluzion grupi i punes propozon qe per periudhen rregullatore 2012-2014 kompanise CEZ Shperndarje per aktivitetin e furnizimit me pakice t'i njihen te ardhurat e kerkuara mesatare prej 40,760 milion leke ne vit.

Tarifat e shërbimeve dhe të shitjes me pakice të energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014

Niveli i Tensionit	Kategoritë e Konsumatoreve	Viti 2012-2014		
		Cmimi (leke/kWh)	Cmimi i energjisë në pik (leke/kWh)	
TENSIONI I MESEM	Kliente të furnizuar në 35 kV			
	Industri	8.50	9.78	
	Tregeti & shërbime	8.50	9.78	
	Bujqësi	8.50	9.78	
	Te tjere	8.50	9.78	
	Kliente të furnizuar në 20/106 kV			
	Industri	9.10	10.47	
	Tregeti & shërbime	10.00	11.50	
	Furra buke, prodhim mielli	7.10	8.17	
	Bujqësi	8.70	10.01	
	Te tjere	9.70	11.16	
	Buxhetore	11.50	13.23	
	TENSIONI I ULET	Kliente të furnizuar në TU		
		Industri	10.50	12.08
Tregeti & shërbime		12.20	14.03	
Furra buke, prodhim mielli		7.60	8.74	
Bujqësi		10.50	12.08	
Te tjere		12.00	13.80	
Buxhetore		14.00	16.10	
Familjare				
Blloku I pare deri në 300 kWh		7.70		
Blloku I dyle mbi 300 kWh		13.50		
Tarifa fikse e shërbimit për leximin "zero" (leke/muaj)		200		
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (shkallë, pompe, ashensor, etj (leke/kWh)		8.00		
* Cmimi i energjisë reaktive do të jetë 15% e cmimit të energjisë aktive				

Orari i pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është

- Për periudhën 1 Nëntor – 31 Mars nga ora 18:00 deri 22:00
- Për periudhën 1 Prill – 31 Tetor nga ora 19:00 deri 23:00

2.10 Tarifa e aksesit

Klientet jo-tarifore, furnizuesit e kualifikuar dhe PVE-te do te faturohen individualisht nga operatori i sistemit te shperndarjes sipas tarifes per akses ne rrjetin e shperndarjes, ne nivelin tensionit ku ata furnizohen.

Ne zbatim te pikes 7.1.1 Perdorimi i rrjetit -te “**Metodologjise se llogaritjes se tarifes se sherbimit te shperndarjes**” – OSSH do te siguroje akses ne rrjet per klientet jo tarifore, furnizuesit e kualifikuar dhe PVE-te. OSSH do te vendose per keta konsumatore nje pagese kapaciteti dhe nje pagese energjie. Pagesa e energjise per furnizuesin publik te shitjes me pakice do te perfshije humbjet totale te energjise ne rrjetin e shperndarjes, ndersa pagesa per energji per furnizuesit e kualifikuar, klientet jo tarifore dhe PVE-te nuk do te perfshije humbjet jo-teknike. Per kete arsye ishte e nevojshme qe nga ana e kompanise CEZ Shperndarje te paraqitej alokimi i kostove jo vetem sipas nivelit te tensioni TM dhe TU, por dhe eliminimi i kostos se humbjes joteknike ne rrjetin TM .

Me gjithë kërkesën e vazhdueshme të ERE-s prej një viti, ende jemi në kushtet kur kompania nuk mundet të alokojë kostot sipas kapacitetit dhe energjisë, por dhe nuk e quan të arsyeshme zbritjen e kostos së humbjes joteknike për këta kliente.

Bazuar në ndarjen e kostove për këte qëllim të paraqitur nga kompania për aktivitetin e shperndarjes si dhe duke reflektuar korrigjimet perkatëse, që i kemi konsideruar si të arsyeshme, në tabelën e mëposhtme paraqiten të ardhurat e kerkuara sipas niveleve të tensionit TM dhe TU.

Ne lidhje me alokimin e kostove sipas nivelit të tensionit:

Shperndarja e te ardhurave	Kosto totale	TM	TU
Totali i te ardhurave	21289	2858	18431
Kostoja e humbjeve	10256	1279	8977
OPEX	5,624	1217	4407
Amortizimi	3966	423	3543
Norma e kthimit	2243	239	2004
Shpërndarja e Kompensimit	0	0	0
Lidhja e re dhe të ardhurat shtesë	-500	0	-500
Energjia reaktive	-300	-300	0
Energjia e Shperndare	4278	886	3392
Kosto mesatare	5.0	3.2	5.4

Shperndarja e kostove eshte bere sipas ketyre kriterëve :

- Energjia e parashikuar per t'u shperndare ne TL/TM dhe TU eshte perdorur per shperndarjen e OPEX-it dhe mekanizmin e kompesimit.
- Humbjet totale ne cdo nivel tensioni sherbejne per shperndarjen e koston se blerjes se energjise elektrike per mbulimin e humbjeve.
- CAPEX eshte shperndare sipas energjise se furnizuar.

Sic shihet dhe nga tabela eshte e veshtire per aresye te mungeses se te dhenave, eliminimi i kostove te energjise elektrike per mbulimin e humbjeve jo-teknike, per te mundesuar ne kete menyre nje llogaritje sa me te drejte dhe te justifikuar te tarifes se aksesit per klientet e kualifikuar.

Llogaritjet e paraqitura tregojne se kompania e shperndarjes se energjise elektrike nuk konsideron humbje jo-teknike ne rrjetin e Tensionit te Mesem dhe te gjitha koston per mbulimin e humbjeve jo-teknike jane alokuar ne rrjetin e tensionit te ulet.

Nga perlllogaritjet e grupit te punes, ne perfundim propozojme qe tarifa e perdorimit te rrejtit te shperndarjes per perdoruesit qe furnizohen ne :

- Rrjetin e TM te jete 3.2 leke/kWh
- Rrjetin e TU te jete 5.4 leke /kWh

2.11 Ne lidhje me tarifen e energjise se furnizuar ne periudhen e pik-ut

Ne dallim nga viti i kaluar, tarifa e pikut propozohet nga kompania CEZ Shperndarje, ne funksionin e tij si furnizues me pakice, te jete ne masen 15% me e larte se tarifa baze e energjise per cdo grup klientesh per vitin 2011, pra kerkon te rivendose cmimin e energjise ne oret pik-ut te njejte me ate te miratuar ne vitin 2010 . Ky ndryshim eshte i aresyeshem meqe situata aktuale eshte e ndryshme nga ajo e viti te kaluar ne te cilin kerkesa u mbulua nga energjia e prodhuar ne vend, pra me burimet hidro, sot jemi ne kushtet e renies se prodhimit me hidro dhe rritjes se konsiderueshme te nevojës per import dhe raporti ndermjet cmimit te energjise ne baze dhe asaj ne pik ne tregun e shitjes me shumice eshte afersisht ne nivelet 15-20%, ashtu sic dhe tregohet ne tabelen

Phelix Futures

Fig. Marredhenia EEX te ardhshem ndermjet cmimeve ne pik dhe baze

Contract	Price Base	Contract	Price Peak	Contract	Price Off-Peak
W35/11	51 €/MWh	W35/11	59.58 €/MWh		
Sep - 11	54.29 €/MWh	Sep - 11	64.4 €/MWh	Sep - 11	48.44 €/MWh
4.11	63.06 €/MWh	4.11	80.23 €/MWh	4.11	53.69 €/MWh
Cal - 12	57.59 €/MWh	Cal - 12	71.36 €/MWh	Cal - 12	49.96 €/MWh

Persa me siper duke u mbeshtur edhe ne gjendjen aktuale, per pamundesine objektive te sigurimit te te dhenave te konsumit ne pik dhe jashte pikut, si pasoje e mungeses se matjes orare per te gjitha klientet tarifore, e gjejmë te arsyetuar propozimin e kompanise, qe cmimi i energjise elektrike ne kohen e pikut te faturohet me 15 % me te larte se cmimi i energjise elektrike te furnizuar ne baze.

Megjithese nga ana e ERE-s eshte kerkuar ne menyre te vazhdueshme pergjate gjithë 6-mujorit te pare te vitit 2011 qe kompania te realizonte studimin per profilin e ngarkeses, i cili do te mundesonte llogaritjen e sakte te tarifes te pikut, por kompania ende vazhdon te mos realizoje nje studim te tille.

Nisur nga rendesia qe paraqet studimi, i lihet detyre kompanise qe ta paraqese per miratim ne ERE, **deri ne fund te 6-mujorit te pare te vitit 2012, studimin i cili do te sherbeje si baze per vendosjen e tarifave te cdo grupi klientesh tarifore sipas niveleve te tensionit, per periudhat e ardhshme rregullatore.**

2.12 Ne lidhje me aplikimin e tarifës fikse për konsumatorët jo familjarë në TM

Megjithatë kompania ka paraqitur në aplikim llogaritjet për aplikimin e një tarife fikse prej 20 leke për kW të instaluar në muaj. Kjo tarife është e arsyeshme dhe bazohet në kërkesat e metodologjisë përkatëse të aktivitetit të shpërndarjes.

Verejme se kompania kur prezanton të ardhurat nga struktura e shitjes nuk ka llogaritur të ardhurat sipas kësaj komponenti. Nga ana tjetër një llogaritje e tillë është e pamundur për mungesë të dhënash (kapacitetet e instaluar për çdo konsumator jo familjar), për këtë arsye nuk mund të llogaritet efekti në të ardhura nga shitja e energjisë elektrike për periudhat përkatëse.

2.13 Tarifa e konsumatorëve familjarë me dy blloqe konsumi

Përsa i përket tarifave me dy blloqe për klientët familjarë propozojmë që të vazhdojnë të ekzistojnë edhe për vitin 2012 me arsyetimin se kjo strukturë dekurajon përdorimin e energjisë elektrike për ngrohje dhe gatim. Këto dy shërbime fare mirë mund të garantohen nga burime alternative me kosto konkurruese.

Struktura e të ardhurave nga shitja e energjisë elektrike nga FPP tek konsumatorët tariforë

Në tabelën e mëposhtme paraqitet struktura e të ardhurave sipas grupeve të konsumatorëve për çdo nivel tensioni, (çmimi i energjisë elektrike në periudhën e pik-ut është 15% më e lartë se energjia elektrike në bazë)

2.14 PERCAKTIMI I ÇMIMIT TE SHITJES TE ENERGJISE PER HEC-et EGZISTUES ME FUQI TE INSTALUAR DERI NE 10 MW DHE TE RINJ ME FUQI DERI NE 15 MW.

Ne te njejten kohe me percaktimin e tarifave dhe çmimeve per sherbimet e energjise elektrike ne kete relacion jane dhene argumentat edhe per rishikimin e çmimeve te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga prodhuesit e vegjel (koncesionare apo private) ekzistues me fuqi te instaluar deri ne 10 MW si dhe te prodhuesve te rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW. Kjo per arsye se çmimi i percaktuar per keto HEC-e do te ndikojë ne te ardhurat e kerkuara per Furnizuesin Publik me Shumice (KESH /FPSH).

Cmimi i shitjes se energjise elektrike per HEC-et ekzistues me fuqi te instaluar deri ne 10 MW

Per llogaritjen e çmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et ekzistues Grupi i Punes ka zbatuar "Metodologjine per llogaritjen e cmimit te unifikuar per shitjen e energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise nga HEC-et me fuqi te instaluar deri 10 ne MW" te miratuar nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me vendimin Nr.5, date 26.01.2007. Ne zbatim te kesaj metodologjie, per llogaritjen e cmimit te shitjes se energjise elektrike do te perdoret formula ne vijim:

$$P_U = (P_R - P_T) * (1 - L_D\%)$$

Ku:

- P_U Cmimi unik i prodhuesve me fuqi deri 10 ne MW,
- P_r Cmimi mesatar i shitjes me pakice te energjise elektrike te klientet tarifore ne shperndarje per vitin 2012 , i cili sipas llogaritjeve te paraqitura ne piken 2.9 te ketij relacioni dhe te propozuar nga Grupi i Punes rezulton **9.53 leke** .
- P_t Tarifa e sherbimit te transmetimit te miratuar nga ERE per vitin 2012 qe sipas llogaritjeve te paraqitura ne piken 2.6 te ketij relacioni propozohet ne **0.65 leke/kWh**
- $L_D\%$ Perqindja e humbjeve teknike ne rrjetin e shperndarjes e pranuar nga ERE per efekt te llogaritjes se cmimit unik sipas kesaj formule. Sipas raportimit periodik te muajit tetor nga CEZ Shperndarje derguar me shkresen Nr.626 Date 27.10.2011 humbjet teknike ne shperndarje per periudhen janar-tetor 2011 jane ne nivelin 12.82 %

$$P_U = (9.53 - 0.61) * (1 - 12.82\%) = 7.77 \text{ leke/kWh}$$

VITI 2012								
Kategorite e Konsumatoreve	Shitja ne Baze (GWh)	Shitja ne Pik (GWh)	Total Shitje (GWh)	Tarifa leke/kWh	Tarifa ne Pik	nga shitja e energjise ne baze	nga shitja e energjise ne Pik	Total te Ardhuara
Kliente te furnizuar ne 35 kV								
Industri	4,603	439	5,042	8.50	9.78	39,126	4,291	43,417
Tregeti & sherbime	31,516	4,029	35,545	8.50	9.78	267,886	39,383	307,269
Bujqesi			0	8.50	9.78	0	0	0
Te tjere	4,311	2,638	6,949	8.50	9.78	36,644	25,786	62,430
Total	40,430	7,106	47,536	1.16		343,655	69,461	413,116
Kliente te furnizuar ne 20/10/6 kV								
Industri	354,523	30,777	385,300	9.10	10.47	3,226,159	322,081	3,548,241
Tregeti & sherbime	213,637	21,384	235,021	10.00	11.50	2,136,370	245,916	2,382,286
Furra buke, prodhim mielli	9,427	1,304	10,731	7.10	8.17	66,932	10,647	77,579
Bujqesi	721	82	803	8.70	10.01	6,273	820	7,093
Te tjere	186,974	20,972	207,946	9.70	11.16	1,813,648	233,943	2,047,590
Buxhetore	46,929	2,753	49,682	11.50	13.23	539,684	36,408	576,092
Total	812,211	77,272	889,483			7,789,065	849,816	8,638,881
Kliente te furnizuar ne TU								
Industri	6,834	2	6,836	10.50	12.08	71,758	23	71,781
Tregeti & sherbime	637,124	13,313	650,437	12.20	14.03	7,772,913	186,781	7,959,694
Furra buke, prodhim mielli	31,354	743	32,097	7.60	8.74	238,290	6,494	244,784
Bujqesi	2,360	56	2,416	10.50	12.08	24,780	676	25,456
Te tjere	78,770	1,932	80,702	12.00	13.80	945,238	26,664	971,902
Buxhetore	105,836	2,358	108,194	14.00	16.10	1,481,706	37,962	1,519,668
Tarifa mesatare jo familjare	862,278	18,404	880,682			10,534,684	258,601	10,793,285
Familjare								
Bloku I pare deri ne 300 kWh	1,621,204	0	1,621,204	7.70		12,483,270	0	12,483,270
Bloku I dyte mbi 300 kWh	619,660	0	619,660	13.50		8,365,412	0	8,365,412
Total familjare	2,325,933		2,240,864			20,848,682	0	20,848,682
Common spaces	52,698	0	52,698	8.00		421,584	0	421,584
Mesatare Totale	4,093,550	102,782	4,111,263		0.00	39,937,670	1,177,878	41,115,548
								39,278,000
								1,837,548

Duke qene se ne llogaritjen e te ardhurave te kerkuara te shoqerise se shperndarjes i jemi referuar vetem cmimeve te shitjes ne baze te klienteve fundore, ne vitin 2012, shoqeria pritet qe te realizoje te ardhura e kerkuara prej 39,937, nderkohe qe nga shitjet e energjise ne pik rezultojne me nje sasi te ardhurash te teperta. Duke patur parasysh qe te ardhurat totale te kerkuara nga shoqeria per vitin 2012 perlllogariten ne vleren 39,278 million leke, diferenca prej 1,837 million leke mund te jene objekt i axhustimit ne rishikimin e tarifave te ardhshme te shoqerise, sipas struktures faktike te shitjes se energjise elektrike per secilin vit te periudhes rregullatore.

Mbeshtetur ne sa me siper, propozohet qe çmimi i shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga te licensuarit konçesionare dhe private, me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, per periudhen 01 Janar 2012 – 31 Dhjetor 2012 te jete 7.77 leke/kWh.

Ky cmim i shitjes se energjise nga keta prodhues per periudhen 2013-2014 do te rillogaritet nese do te kete ndryshime ne komponentet perkates si pasoje e rillogaritjeve qe do te behen ne tarifat e sherbimit te furnizimit me shumice, shperndarjes, dhe te furnizimit me pakice

2.15 Cmimi i shitjes se energjise elektrike per HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri 15 MW

Per llogaritjen e çmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri 15 MW kemi zbatuar "Metodologjine per percaktimin e cmimit unik te energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW te dhene me koncension ne baze te Ligjit Nr. 9663, date 18.12.2006 "Per Koncensionet" " metodologji e miratuar nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me vendimin Nr.24, date 11.04.2007. Sipas metodologjise se siperpermendur, per llogaritjen e cmimit te shitjes se energjise elektrike do te perdoret formula ne vijim:

$$P_u = P_i * 1.1 * R_{EX}$$

Ku :

- P_u eshte cmimi unik i energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW,
- P_i eshte cmimi mesatar i importit te energjise elektrike te realizuar nga KESH sh.a. (ne funksionin e FPSH) ne vitin parardhes. Nisur nga informacioni mbi shpenzimet faktike te importit ne vitin 2011 qe KESH sh.a. ka paraqitur ne aplikimin per tarifat per 2012-2014 rezulton nje cmim mesatar i importit prej **60.18 €/MWh**
- 1.1 Koeficient, bonusi qe u jepet te licensuarve per prodhimin e energjise elektrike nga keta HEC-e.
- R_{EX} norma mesatare e shkembimit Leke/EUR te publikuar nga Banka e Shqiperise per vitin parardhes. Nga perpunimi i informacionit te publikuar nga Banka e Shqiperise mbi kursin e kembimit Leke/EUR ne cdo dite te periudhes 01 Janar- 28 Nentor 2010 rezulton nje kurs mesatar **140.5 Leke/EUR** per vitin 2011.

$$P_u = 60.18 * 1.1 * 140.5 = 9.30 \text{ leke /kWh}$$

Nisur nga treguesit e percakuar si me lart rezulton nje cmim prej 9.30 leke/kWh. (Ne rast se do te merrej ne konsiderate cmimi i importit nga CEZ Shperndarje sh.a. do te rezultonte nje cmim 7.82 leke/kWh)

Sa me siper, grupi i punes propozon qe çmimi i shitjes se energjise elektrike nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW nga te licensuarit konçesionare dhe private per periudhen 01 Janar 2012 – 31 Dhjetor 2012 te jete nqs marrim per baze cmimin mesatar te importit te KESH sh.a dhe nqs si baze marrim per baze cmimin mesatar te importit te CEZ Shperndarje sh.a.

Per vitet 2013 dhe 2014 do te rillogariten sipas te dhenave korente te periudhave perkatese per cmimin e energjise elektrike te blere nga importi

	Periudha				
	2011	2012	2013	2014	Mesatarja (2012-2014)
Cmimi mesatar	9.53 leke/kwh	9.53 lek/kWh	9.53 lek/kWh	9.53 lek/kWh	9.53 lek/kWh
KESH / FPSH	1.48 lek/kWh	2.84 lek/kWh	2.51 lek/kWh	3.14 lek/kWh	2.83 lek/kWh
OST	0.6 lek/kWh	0.61 lek/kWh	0.70 lek/kWh	0.65 lek/kWh	0.65 lek/kWh 8.3
OSSH/CEZ (shperndarje	7.45 lek/kWh	6.08 lek/kWh	6.32 lek/kWh	5.74 lek/kWh	6.05 lek/kWh (19%)

Bashkelidhur ne kete relacion jane propozuar dhe Projekt – Vendimet lidhur me tarifat dhe çmimet e sherbimeve te energjise elektrike te llogaritura me siper.